19077

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT
Nr. 19077 Rregj.

VENDIM
PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 19 .03.1998, Une _____ gjyqtare ne Gjykaten e ketij rrethi pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesit Hasan HAFIZI , Sh.p.k. "KARL GEGA KONSTRUKSION" dhe Sh.A . "COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAL" per rregjistrimin si person juridik:

KONSTATOVA

Se kerkuesit Hasan HAFIZI , Sh.p.k. " KARL GEGA KONSTRUKSION " dhe Sh.A. Franceze "COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAL", kane paraqitur kerkesen dhe materialet e tjera per rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me ortakeri me emertimin "ALBAVIA" , me kapital themeltar 100.000 (Njeqind mije leke) e perbere 25% Z. Hasan HAFIZI, 25% Sh.p.k. " KARL GEGA KONSTRUKSION" dhe 50% Sh.A. "COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAL", me seli ne qytetin e Tiranes ne rrugen " Sami Frasheri ", Pall.20/1, shk.1, Ap.17, me kohezgjatje te veprimtarise ekonomike private pa nderprerje mbi 10 vjet, me administratore Z. Hasan HAFIZI, Z.Jean Louis MARCHAND, Z. Maurice MOISY dhe Z.Valentina KRUJA, me objekt te veprimtarise ekonomike private ne fushen ndertimore si konsulenca, projektime, ndertime rrugesh te te gjithe kategorive, perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj); Ndertim pistash e aeroportesh; Ndertim veshjesh asfaltike e shtresash rrugore; Punime dherash, sistemime, tarracime terrenesh, etj; Punime te rikonstruksionit, mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijezimit te rrugeve; Ndertime te veprave te artit rrugore e hekurudhore te te gjithe kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, vija dukte, tunele etj); Punime topogjeodezike, gjeologjike dhe analizash laboratorike per punimet rrugore; Administrim dhe shfrytezim te guroreve , kavove te zhavorrit, karierave te rerave bituminoze, impianteve te betonit, impianteve te perzierjeve bituminoze, impianteve te prodhimit te inerteve etj, perfshire dhe tregtimin e materialeve teknologjike te prodhuar si dhe materialeve te ndertimit , industriale etj; Konsulence, projektime, ndertime dhe supervizion ne fushat e ndertimeve industriale , hidroteknike, civile, urbanistike, turizmit, ushtarake, objekte kulti, kulturore, sportive etj perfshire dhe restaurimin, rikonstruksionin e mirembajtjen e veprave ekzistuese ; Koncensione dhe investime ne te gjitha fushat; Importim dhe eksportim te te gjitha llojeve te materialeve dhe mallrave, paisjeve dhe makinerive te ndryshme; Levrim te teknikave te ndertimit sipas teknologjive bashkekohore; Aktivitet marketingu dhe kualifikim profesional; Perfaqesime ndermjetesime, kooperime dhe tranzitime per probleme te karakterit te ndryshem per vendas dhe te huaj.

Kjo kerkese eshte ne perputhje me ligjet dhe me kushtet materiale te tij prandaj duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 dhe ligjit 7667 dt.28.01.1993

VENDOSA

Te bej rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me ortakeri me emertimin "ALBAVIA" te ortakeve Hasan HAFIZI , Sh.p.k. " KARL GEGA KONSTRUSION" dhe Sh.A. "COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAL" me kapital themeltar 100.000 (njeqind mije lek) e perbere 25% Z. Hasan HAFIZI, 25% Sh.p.k. "KARL GEGA KONSTRUKSION" dhe 50% Sh.A. "COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAL", me seli ne qytetin e Tiranes ne rrugen " Sami Frasheri", Pall.20/1, shk.1, Ap.17 , me kohezgjatje te veprimtarise ekonomike pa nderprerje mbi 10 vjet, me administratore Z. Hazan HAFIZI, Z. Jean Lois MARCHAND, Z. Maurice MOISY dhe Z. Valentinaa KRUJA. Me objekt te veprimtarise ekonomike private ne fushen ndertimore si : konsulenca , projektime, ndertim rrugesh te te gjitha kategorive perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj) ; Ndertim pistash e aeroportesh; Ndertim veshjesh asfaltike e shtresash rrugore; Punime dherash , sistemime, tarracime terrenesh etj; Punime te rikonstruksionit mirembajtjes , sinjalizimit dhe vijezimit te rrugeve; Ndertime te veprave te artit rrugor e hekurudhor te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, vija dukta, tunele etj) ; Punime topogjeodezike , gjeologjike dhe analizash laboratorike per punimet rrugore; Administrim dhe shfrytezim te guroreve , kavove te zhavorit, karierave te rerave bituminoze, impianteve te betonit, impianteve te perzierjeve bituminoze, impianteve te prodhimit te inerteve etj, perfshire dhe tregtimin e materialeve teknologjike te prodhuar si dhe materialeve te ndertimit ,industriale etj; Konsulenca ,projektime ndertime dhe supervizion ne fushat e ndertimeve industriale, hidroteknike, civile, urbanistike , turizmit, ushtarake,objekte kulti, kulturore, sportive etj, perfshire dhe restaurimin , rikonstruksionin dhe mirembajtjen e veprave ekzistuese ; Koncensione dhe investime ne te gjitha fushat; Importim dhe eksportim te te gjitha llojeve te materialeve dhe mallrave , paisjeve dhe makinerive te ndryshme; Levrim te teknikave te ndertimit sipas teknologjive bashkekohore; Aktivitet marketingu dhe kualifikim, profesional; Perfaqesime, ndermjetesime, kooperime dhe tranzitime per probleme te karakterit te ndryshem per vendas dhe te huaj.

Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 3413/2 VENDIMI
4982

VENDIMI

I gjyqtarit te vetem

Ne Tirane sot me date 18-03-1998, Une M. Seli gjyqtare ne Gjykaten e rrethit Tirane pasi studjova kekesen dhe materialet e tjera te paraqitura nga kerkuesit LUAN KOPLIKU, LUMNIJE FETIU, ARSHI RAKIPAJ, HARTJAN SALLAKU per disa ndryshime dhe regjistrimin e dokumentave ne regjistrin tregtar Tirane te Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me ortakeri "Karl Gega Konstruksion":

KONSTATOVA

Se ne baze te vendimeve te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 3413 date 02.04.1994 dhe Nr. 3413/1 date 22.12.1994 eshte regjistruar si Person Juridik Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me ortakeri me emertimin "Karl Gega Konstruksion", me seli ne qytetin e Shkodres ne rrugen "Marin Barleti" Pall. 175, me kapital themeltar 1000 USD me kohe zgjatje te veprimtarise ekonomike pa nderprerje mbi 10 vjet me administrator Z. SHKELQIM RAKIPAJ, LUAN KOPLIKU DHE HARTJAN SALLAKU, me objekt te aktivitetit tregtar privat ne fushen e projektimit e zbatimit, ne fushen e ndertimeve te ndryshme civile, industriale, banesa, hotele, objekte kulti, infrastrukture prodhim e perpunim te materialeve te ndertimit, transportimi dhe tregtimi i tyre, importim dhe eksportim i materialeve te ndertimit si dhe i mallrave dhe materialeve te ndryshme te industrise se rende dhe te lehte dhe ushqimore, tregtimi i tyre me shumice, investimi ne te gjitha fushat e ndertimit, komunikacion, bujqesi, krijimi i ambjenteve shlodhese, tregtimi i materialeve farmaceutike, hapje lokalesh, kafenesh, restorantesh, hotelesh, diskoteka, kende lojrash, perfaqesim, koperim dhe

ndermjetesim ne aktivitet tregtare prodhuese, sherbimesh te sistemit komunal si dhe ne fushen e tranzitimit te mallrave dhe te sherbimeve, magazinimi dhe shperndarja e materialeve te ndryshme, organizimi dhe paisja e panaireve dhe ekspozitave, sherbimeve, reklama dhe marketing.

Me vendim Nr. 2 date 29.10.1997 te Asamblese se Ortakeve eshte vendosur largimi nga kjo Shoqeri i dy ortakeve ARSHI RAKIPAJ dhe LUMNIJE FETIU, pranimi ne kete Shoqeri i dy ortakeve te tjere i HASAN HAFIZIT dhe SHKELQIM RAKIPAJ, dhe eshte vendosur lenja si administratore te Shoqerise i tre ortakeve SHKELQIM RAKIPAJ, LUAN KOPLIKU dhe HARTJAN SALLAKU. Gjithashtu Asambleja e Ortakeve ka vendosur hapjen e nje Dege te kesaj Shoqerie ne Tirane ne rrugen "Ferit Xhajko" Pall 65/3 Sh.2, Ap. 12 me Nr. Tel 287-62. Fitimi i realizuar nga aktiviteti ekonomik i Shoqeris do te ndahet ne menyre te barabarte ndermjet Ortakeve sipas kuotave te derdhura ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise nga 25% sejcili.

Kjo kerkese eshte e bazuar ne ligje dhe duhet pranuar.

PER KETE ARSYE

Ne baze te Ligjit 7638 dt. 19.11.1992 dhe Ligjit 7667 dt. 28.01.1993

VENDOSA

—Pranimin e kerkeses

—Depozitimin ne zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave per paraqitura ne emer te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me ortakeri "Karl Gega Konstruksion"

—Urdherimin e zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane te beje ndryshimet ne kollonen _____4_____ te regjistrit tregtar.

—Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

~~Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim.~~

GJYQTARE

Mayaoui Sedi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Vendimi nr. /9022/1
7101

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
- PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK -

Sot me date 21/09/1999, une [illegible], Gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Z. Hasan Hafizi, administrator i shoqerise ALBAVIA Shpk., per depozitimin e vendimeve te Asamblese se Ortakeve te shoqerise ALBAVIA Shpk. te datave 08.07.1999 dhe 08.09.1999, dhe per regjistrimin ne regjistrin tregtar te ndryshimeve sipas ketyre vendimeve, dhe dokumentet perkates nga te cilet:

KONSTATOVA:

Se, ALBAVIA Shpk. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me kapital fillestar 100.000 Leke, regjistruar si person juridik me vendimin nr.19077, date 19.03.1998 e Gjykates se Rrethit Tirane.

Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise e mbledhur me date 08.07.1999 ka vendosur :

1- Te miratoje terheqjen nga shoqeria te ortakut KARL GEGA KONSTRUKSION Shpk., pasi i ka shitur te 25 kuotat qe zoteronte ortakut Hasan Hafizi nepermjet kontrates nr.651 Rep. dhe nr.87 Kol. date 01 Korrik 1999, (Aneksi A i vendimit te asamblese). Si rrjedhoje e ketij largimi pjesemarrja e ortakeve ne shoqeri ndryshon si me poshte:

- EUROVIA INTERNATIONAL 50 kuota me vlere nominale 1.000 Leke secila;
- Hasan Hafizi 50 kuota me vlere nominale 1.000 Leke secila.

2- Te zmadhoje kapitalin e shoqerise nga 100.000 (njeqind mije) Leke ne 23.780.000 (njezet e tre milione e shtateqind e tetedhjete mije) Leke. Per te realizuar zmadhimin e kapitalit,

- Ortaku Hasan Hafizi do te kontribuoje me shumen 4.753.800 (kater milione e shtateqind e pesedhjete e tre mije e teteqind) Leke, te cilen do ta shlyeje duke e derdhur teresisht ne te holla ne llogarine bankare te shoqerise; kurse
- Ortaku EUROVIA INTERNATIONAL do te kontribuoje me shumen 18.926.200 (tetembedhjete milione e nenteqind e njezete e gjashte mije e dyqind) Leke. EUROVIA INTERNATIONAL do te shlyeje shumen 18.926.200 (tetembedhjete milione e nenteqind e njezete e gjashte mije e dyqind) Leke qe i korrespondon 928.137,08 FRF (nenteqind e njezete e tete mije e njeqind e tridhjete e shtate presje zero tete franga franceze), si me poshte:

- Shuma 230.000 FRF (dyqind e tridhjete mije franga franceze) qe EUROVIA INTERNATIONAL i ka dhene ne forme huaje shoqerise ALBAVIA Shpk. sipas transfertes bankare te dates 07.05.1998 (dokumenti bashkengjitur si Aneksi B) do te perdoret per zmadhimin e kapitalit te shoqerise ALBAVIA Shpk., duke e konsideruar huane te shlyer.
- Diferenca 698.137,08 FRF (gjashteqind e nentedhjete e tete mije e njeqind e tridhjete e shtate presje zero tete faranga franceze) do te kalohet me transferte bankare ne llogarine e shoqerise ALBAVIA Shpk.

Ne llogaritjet e mesiperme eshte marre per baze kursi i kembimit i publikuar nga Banka Kombetare Tregtare me date 8 Korrik 1999, 1 FRF = 20,3916 Leke (kursi i kembimit - Aneksi C i vendimit te asamblese).

Pas ketij zmadhimi, kapitali i shoqerise do te jete 23.780.000 (njezet e tre milione e shtateqind e tetedhjete mije) Leke i ndare ne 290 kuotat me vlere 82.000 (tetedhjete e dy mije) Leke secila, nga te cilat 202 i zoteron ortaku EUROVIA INTERNATIONAL, kurse 88 kuota i zoteron ortaku Hasan Hafizi.

3- Te miratoje ndryshimet e meposhtme te statutit te shoqerise :

"Neni 14

Kapitali i shoqerise eshte 23.780.000 (njezet e tre milione e shtateqind e tetedhjete mije) Leke i ndare ne 290 pjese (kuota) me vlere 82.000 (tetedhjete e dy mije) Leke secila.

Neni 15

Kapitali i shoqerise eshte i ndare si me poshte :

- ortaku EUROVIA INTERNATIONAL	202 kuota
- ortaku Hasan Hafizi	88 kuota "

Ortaku Hasan Hafizi ka derdhur ne llogarine bankare te shoqerise ALBAVIA Shpk. shumen 4.753.800 Leke, sipas çertifikates bankare te leshuar nga Banka e Tiranes me date 13.08.1999. Kurse ortaku EUROVIA INTERNATIONAL ka derdhur ne llogarine bankare te shoqerise ALBAVIA Shpk. shumen 730.000 FRF, sipas çertifikates bankare te leshuar nga Banka e Tiranes me date 13.08.1999.

Asambleja e Ortakeve te shoqerise e mbledhur me date 09.09.1999 vendosi qe te miratoje doreheqjen e Znj. Valentina Kruja nga detyra e administratores. Ne vend te saj emerohet administrator Z. Philippe Peytavin, shtetas francez, lindur ne France me 20.10.1950, mbajtes i pasaportes nr.920298023304. Ai do te kete te gjitha kompetencat qe i njihen nje administratori sipas statutit te shoqerise dhe do te qendroje ne detyre per periudhen kohore qe ka mbetur deri ne fund te mandatit te Znj. Valentina Kruja, sipas nenit 39 te statutit te shoqerise.

Pas ketij ndryshimi administratoret e shoqerise ALBAVIA Shpk. jane :

- Z. Hasan Hafizi
- Z. Jean Louis Marchand
- Z. Maurice Moisy
- Z. Philippe Peytavin

Gjithashtu konstatova se kerkesa per depozitimin e vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise ALBAVIA Shpk. dhe ak teve te tjera bashkengjitur, si dhe regjistrimin e ndryshimeve perkatese ne regjistrin tregtar, eshte e bazuar ne ligj, dhe

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregtar, te vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise ALBAVIA Shpk., date 08.07.1999; kontraten per shitjen e kuotave date 01.07.1999, nr. 651 Rep. Dhe nr. 87 Kol. te lidhur midis KARL GEGA KONSTRUKSION Shpk. dhe Hasan Hafizit; tabelen e kursit te kembimit te publikuar nga Banka Kombetare Tregtare me date 08.07.1999; çertifikaten bankare date 29.06.1998 te leshuar nga Banka e Tiranes; dy çertifikata bankare te leshuara nga Banka e Tiranes me date 13.08.1999; vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise ALBAVIA Shpk. date 08.09.1999; Deklaraten e Znj. Valentina Kruja per doreheqjen nga detyra e administratores se shoqerise; Deklaraten e Z. Philippe Peytavin, i cili pranon detyren e administratorit qe i ngarkohet; dy prokura qe autorizojne Z. Maurice Moisy per te votuar ne Asamblene e Ortakeve te shoqerise ALBAVIA Shpk., ne emer te ortakut EUROVIA INTERNATIONAL; Ekstrakt i regjistrit te gjykates tregtare franceze per te dhenat e shoqerise EUROVIA INTERNATIONAL.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen _____, germa ____, si dhe te behet ndarja nga njeri-tjetri me vize te kuqe.

G J Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Vendimi nr. 19077/2
Nr. Akti _____

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me 15.1.2004, une M. Doçi, Gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria ALBAVIA Shpk., per depozitimin prane Regjistrit Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te dates 29.06.2000 dhe dokumentet e tjera bashkengjitur kesaj kerkese nga te cilet

KONSTATOVA:

Se shoqeria ALBAVIA Shpk., eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 19077, date 19.03.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.
Ne daten 29.06.2000, Asambleja e Ortakeve te shoqerise Albavia Shpk., ka vendosur si me poshte:
1. Miratimin e doreheqjes se Administratorit Z. Maurice Moisy dhe zevendesimin e tij me Z. Luc Bodson. Z. Bodson do te kete te njejtat kompetenca qe kishte Z. Moisy ne detyren e Administratorit.
Me kete ndryshim, Administratoret e shoqerise ALBAVIA Shpk. jane si me poshte:
- Z. Jean Louis Marchand
- Z. Hasan Hafizi
- Z. Philippe Peytavin
- Z. Luc Bodson

2. Rishikimin e kompetencave te Z. Hasan HAFIZI, ne cilesine e Administratorit te Autorizuar te shoqerise sipas autorizimit te dates 31 dhjetor 1999 (autorizim i cili i bashkengjitet vendimit te asamblese). Kompetencat e Z. Hafizi ndryshojne si me poshte:
- Ne paragrafin 1.12 te autorizimit te siperpermendur, shuma 10.000.000 (dhjete milione) Leke ndryshohet ne 20.000.000 (njezet milione) Leke.
- Permbajtja e paragrafit 1.17 te autorizimit ndryshohet si vijon: "Te kryeje blerjet e mallrave te ngurtesuara ne llogari me vlere me te madhe se 20.000 (njezet mije) USD.
- Ne paragrafin 4.1 te autorizimit, shuma 100.000.000 (njeqind milione) Leke ndryshohet ne 200.000.000 (dyqind milione) Leke.
- Ne paragrafin 4.2 te autorizimit, shuma 100.000.000 (njeqind milione) Leke ndryshohet ne 200.000.000 (dyqind milione) Leke.

3. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga 23.780.000 (njezet e tre milione e shtateqind e tetedhjete mije) Leke ne 48.134.000 (dyzet e tete milione e njeqind e tridhjete e kater mije) Leke si dhe pasqyrimi i ndryshimeve perkatese ne statutin e shoqerise.
Per te realizuar zmadhimin e kapitalit te shoqerise si me siper, ortaku Hasan Hafizi do te derdhe ne llogarine bankare te shoqerise ALBAVIA Shpk., shumen prej 7.380.000 (shtate milione e treqind e tetedhjete mije) Leke.
Ortaku EUROVIA INTERNATIONAL i ka dhene shoqerise ALBAVIA Shpk. nje hua ne shumen 550.000

(peseqind e pesedhjete mije) Euro ne baze te kontrates se huase te lidhur midis tyre ne date 3 maj 2000. EUROVIA INTERNATIONAL do te zbrese nga kjo hua ekuivalencen e shumes 16.974.000 (gjashtembedhjete milione e nenteqind e shtatedhjete e kater mije) Leke e cila do te perdoret per te shlyer pjesen qe ortaku EUROVIA INTERNATIONAL kontribuon per zmadhimin e kapitalit te shoqerise ALBAVIA Shpk..

Me realizimin e ketij zmadhimi, kapitali i shoqerise behet 48.134.000 (dyzet e tete milione e njeqind e tridhjete e kater mije) Leke i ndare ne 587 kuota nga Leke 82.000 (tetedhjete e dy mije) Leke secila dhe zoterohet nga ortaket si me poshte ndahet si vijon:

EUROVIA INTERNATIONAL	- 409 kuota ose 69,68 % e kapitalit
Hasan Hafizi	- 178 kuota ose 30,32 % e kapitalit

Me qellim qe ndryshimet e mesiperme te pasqyrohen ne statutin e shoqerise ortaket vendosen te bejne ndryshimet e meposhtme ne statut:

"Neni 14

Kapitali i shoqerise eshte 48.134.000 (dyzet e tete milione e njeqind e tridhjete e kater mije) Leke i ndare ne 587 kuota nga 82.000 (tetedhjete e dy mije) Leke secila.

Neni 15

Kapitali i shoqerise eshte i ndare midis ortakeve si me poshte:

EUROVIA INTERNATIONAL	- 409 kuota ose 69,68 % e kapitalit
Hasan Hafizi	- 178 kuota ose 30,32 % e kapitalit"

Asambleja e Ortakeve unanimisht autorizon Z. Hasan Hafizi qe te perfaqesoje shoqerine ALBAVIA Shpk. duke nenshkruar çdo dokument e duke kryer te gjitha veprimet e nevojshme per te depozituar dhe regjistruar kete vendim te Asamblese se Ortakeve te shoqerise ne regjistrin tregtar shqiptar. Z. Hasan Hafizi i njihet e drejta qe te emeroje avokate dhe t'i autorizoje qe te pergatisin dhe te nenshkruajne ne emer te tij dokumentacionin perkates dhe te kryejne te gjitha veprimet e nevojshme per te realizuar qellimin e siperpermendur.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te ALBAVIA Shpk. date 29.06.2000 per:

1. Miratimin e doreheqjes se Administratorit Z. Maurice Moisy dhe zevendesimin e tij me Z. Luc Bodson, si dhe te vendimit per rishikimin e kompetencave te Z. Hasan Hafizi ne cilesine e Administratorit te autorizuar te shoqerise. Z. Bodson do te kete te njejtat kompetenca qe kishte Z. Moisy ne detyren e Administratorit.

Me kete ndryshim, Administratoret e shoqerise ALBAVIA Shpk. jane si me poshte:

- Z. Jean Louis Marchand
- Z. Hasan Hafizi
- Z. Philippe Peytavin
- Z. Luc Bodson

2. Rishikimin e kompetencave te Z. Hasan HAFIZI, ne cilesine e Administratorit te Autorizuar te shoqerise sipas autorizimit te dates 31 dhjetor 1999 (autorizim i cili i bashkengjitet vendimit te asamblese). Kompetencat e Z. Hafizi ndryshojne si me poshte:

- Ne paragrafin 1.12 te autorizimit te siperpermendur, shuma 10.000.000 (dhjete milione) Leke ndryshohet ne 20.000.000 (njezet milione) Leke.
- Permbajtja e paragrafit 1.17 te autorizimit ndryshohet si vijon: "Te kryeje blerjet e mallrave te ngurtesuara ne llogari me vlere me te madhe se 20.000 (njezet mije) USD.
- Ne paragrafin 4.1 te autorizimit, shuma 100.000.000 (njeqind milione) Leke ndryshohet ne 200.000.000 (dyqind milione) Leke.
- Ne paragrafin 4.2 te autorizimit, shuma 100.000.000 (njeqind milione) Leke ndryshohet ne 200.000.000 (dyqind milione) Leke.

3. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga 23.780.000 Leke ne 48.134.000 Leke si dhe pasqyrimi i ndryshimeve perkatese ne statutin e shoqerise si me poshte vijon:

"Neni 14

Kapitali i shoqerise eshte 48.134.000 (dyzet e tete milione e njeqind e tridhjete e kater mije) Leke i ndare ne 587 kuota nga 82.000 (tetedhjete e dy mije) Leke secila.

Neni 15

Kapitali i shoqerise eshte i ndare midis ortakeve si me poshte:

EUROVIA INTERNATIONAL	- 409 kuota ose 69,68 % e kapitalit
Hasan Hafizi	- 178 kuota ose 30,32 % e kapitalit"

Te gjitha nenet e tjera te statutit mbeten te pandryshuara.

- Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri-tjetri, ne kollonen ___, germa___.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim.

G J Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Vendimi nr. 19077/3

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 09.04.2003, une _____, Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria ALBAVIA Shpk., per depozitimin prane Regjistrit Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te dates 12.06.2001 dhe dokumentet e tjera bashkengjitur kesaj kerkese nga te cilet

KONSTATOVA:

Se shoqeria ALBAVIA Shpk., eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 19077, date 19.03.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me date 12.06.2001 Asambleja e Ortakeve te shoqerise "ALBAVIA" Shpk. ka vendosur:

1. Miratimin e doreheqjes se Administratorit Z. Luc BODSON dhe zevendesimin e tij me Z. Daniel ROFFET.
2. Emerimi i Z. Didier CHAPATTE ne cilesine e Administratorit te shoqerise "ALBAVIA" Shpk..

Pas ketij ndryshimi, Administratoret e shoqerise ALBAVIA Shpk. jane si me poshte:

- Z. Jean Louis MARCHAND
- Z. Daniel ROFFET
- Z. Philippe PEYTAVIN
- Z. Didier CHAPATTE
- Z. Hasan HAFIZI

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses dhe depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te ALBAVIA Shpk. date 12.06.2001
- Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri-tjetri, ne kollonen 4, germa___.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Vendimi nr. 19077/ 4

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 4.07.2003, une Marjana Dedi, Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria Albavia Shpk., per depozitimin prane Regjistrit Tregtar te Vendimeve te Asamblese se Ortakeve te dates 23.05.2003 dhe dokumentet e tjera bashkengjitur kesaj kerkese nga te cilet

KONSTATOVA:

Se shoqeria Albavia Shpk., eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 19077, date 19.03.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me date 23.05.2003 Asambleja e Ortakeve te shoqerise Albavia Shpk. ka vendosur:

1. Miratimin e marrjes nga ana e shoqerise Albavia Shpk. te kredive bankare, huave dhe linjave te llogarive bankare te zbuluara, etj. te leshuara nga "Commercial Bank of Greece, Albania", pa kufizim persa i perket datave te shlyerjeve, si dhe miratimin e te gjitha transaksioneve bankare te lidhura me kredite, huate etj. qe shoqeria Albavia SHpk. do te realizoje nepermjet kesaj banke, brenda kufijve maksimale te pershkruar me poshte:
   - Linje llogarie bankare te zbuluar prej 300.000 (treqind mije) USD.
   - Hua afatgjate/shkurter prej 400.000 (katerqind mije) USD per financimin e investimeve te ardhshme te Shoqerise.

Miratimin e nenshkrimit nga shoqeria Albavia Shpk. te garancive dhe te marreveshjeve siguruese ne favor te "Commercial Bank of Greece, Albania" ne kufijte maksimale te percaktuar ketu me poshte, persa i takon:
   - Sigurimit nepermjet kontratave qe shoqeria ALBAVIA Shpk. ka ne proces zbatimi;
   - Sigurimit nepermjet te gjitha aktiveve ne pronesi te shoqerise ne momentin e nenshkrimit te marreveshjeve te siperpermendura me "Commercial Bank of Greece, Albania".

2. Autorizohet Zoti Hasan HAFIZI, lindur me 11 Shkurt 1955 ne Lezhe, mbajtes i pasaportes nr. 012688, Administrator i Shoqerise Albavia Shpk., te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise me qellim ekzekutimin e vendimit te siperpermendur. Per kete qellim, Z. Hafizi, duke vepruar vetem ose nepermjet personave te trete qe ai mund te caktoje, eshte i autorizuar:
   - Te kerkoje kredi bankare, hua e linja llogarish bankare te zbuluara, etj., dhe te negocioje kushtet kontraktuale te ketyre kredive, etj.;
   - Te nenshkruaje te gjitha aktet ndermjet "Commercial Bank of Greece, Albania" dhe shoqerise Albavia Shpk. lidhur me kredite bankare, huate dhe linjat e llogarive bankare te zbuluara etj., brenda kushteve te percaktuara ketu me siper;
   - Te nenshkruaje garanci dhe marreveshje siguruese, brenda kufijve maksimale te percaktuar ketu me siper, duke perfshire marreveshje pengu, hipoteke, barre siguruese si dhe te gjitha marreveshjet lidhur me cedimin e te drejtave qe rrjedhin nga kontratat qe shoqeria ka nenshkruar me te trete;

- Te perdore fondet e kredive, te hape nje ose me shume llogari bankare tek "Commercial Bank of Greece, Albania", te kryeje transferta bankare me keto llogari si dhe çdo lloj transaksioni tjeter prane "Commercial Bank of Greece, Albania";
- Te nenshkruaje çdo lloj akti tjeter dhe te marre masat e nevojshme ose te kryeje formalitetet e kerkuara per te ekzekutuar angazhimet e marra nga shoqeria Albavia Shpk. kundrejt "Commercial Bank of Greece, Albania".

Ky Autorizim ka efekt deri ne daten 31 dhjetor 2003. Ne rast se perpara perfundimit te ketij afati, Asambleja e Ortakeve te Shoqerise vendos te revokoje kete Autorizim ose nese Z. Hafizi deklaron se nuk pranon me kompetencat e dhena me siper, Shoqeria Albavia Shpk. do te njoftoje per kete menjehere me shkrim "Commercial Bank of Greece, Albania". Revokimi i autorizimit ka efekt kundrejt "Commercial Bank of Greece, Albania" te nesermen e dates se marrjes se ketij njoftimi.

3. Miratimin me ndryshimet e meposhtme te kompetencave te dhena Z. Hasan Hafizi ne cilesine e Administratorit te Deleguar te Shoqerise me Autorizimin e dates 31.12.1999, ndryshuar me Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te dates 29.062000:

- Shuma prej 100.000.000 Leke e permendur ne paragrafin 4.1 te Autorizimit, e ndryshuar ne 200.000.000 Leke nga Asambleja e Ortakeve e dates 29.06.2000, rritet ne shumen 300.000.000 Leke (treqind milion).
- Shuma prej 100.000.000 Leke e permendur ne paragrafin 4.2 te Autorizimit, e ndryshuar ne 200.000.000 Leke nga Asambleja e Ortakeve e dates 29.06.2000, rritet ne shumen 300.000.000 Leke (treqind milion).
- Nje Autorizim i ri i cili do te hartohet per te reflektuar ndryshimet e siperpermendura, do te zevendesoje Autorizimin aktual te dates 31.12.1999.
- Klauzolat e tjera te Autorizimit mbeten te pandryshuara.

4. Miratimin e doreheqjes se Z. Didier Chapatte nga funksionet e tij si Administrator i shoqerise, me efekt nga data 23.05.2003 per shkak te emerimit te tij ne nje funksion tjeter.

Pas ketij vendimi, Administratoret e shoqerise Albavia Shpk. jane si me poshte:

- Z. Jean-Louis Marchand, i emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve 19.03.1998.
- Z. Hasan Hafizi, i emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve 19.03.1998.
- Z. Philippe Peytavin, i emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve 09.09.1999.
- Z. Daniel ROFFET, i emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve 12.06.2001.

Ne perputhje me nenin 39 te statutit te shoqerise, Asambleja e Ortakeve konstaton se mandatet e Administratoreve Marchand, Peytavin dhe Hafizi jane rinovuar heshturazi, per nje periudhe tre-vjecare, me vendimin e Asamblese se Ortakeve te dates 12.06.2001. Ne keto kushte, Asambleja e Ortakeve konstaton se nuk ka vend per te rinovuar mandatet e Administratoreve te shoqerise Albavia SHpk. perpara vitit 2004.

5. Autorizohet Z. Hafizi qe te kryeje, personalisht ose nepermjet personave te tjere qe ai mund te caktoje, te gjitha veprimet e nevojshme per depozitimin e vendimeve te Asamblese ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe te gjitha formalitetet e nevojshme qe kane te bejne me Asamblete ne fjale.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses dhe depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimeve te Asambleve te Ortakeve te ALBAVIA Shpk. date 23.05.2003
- Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri-tjetri, ne kollonen ___, germa___.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Vendimi nr. 19077/5

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 14.10.2003, une _____, Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria Albavia Shpk., per depozitimin prane Regjistrit Tregtar te Vendimeve te Asamblese se Ortakeve te dates 24.09.2003 dhe dokumentet e tjera bashkengjitur kesaj kerkese nga te cilet

KONSTATOVA:

Se shoqeria Albavia Shpk., eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 19077, date 19.03.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.
Me date 24 shtator 2003 Asambleja e Ortakeve te shoqerise "ALBAVIA" Shpk., me unanimitet ka vendosur:

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise i cili aktualisht eshte 48.134.000 Leke (dyzet e tete milion njeqind e tridhjete e kater mije) i ndare ne 587 kuota me vlere 82.000 Leke (tetedhjete dy mije) secila. Kapitali i shoqerise zmadhohet me shumen prej 17.302.000 Leke (shtatembedhjete milion treqind e dy mije), shume e cila shlyhet teresisht ne para nga Ortaku Hasan HAFIZI.
   Zmadhimi i kapitalit te shoqerise realizohet nepermjet rritjes se numrit te kuotave te kapitalit me 211 kuota te reja me vlere 82.000 leke secila. Keto kuota te reja do te emetohen me nje prim prej 8.055 Leke secila; primi i te gjithe kuotave te reja eshte 1.699.605 Leke (nje milion gjashteqind nentedhjete e nente mije gjashteqind e pese), shume e cila do te shlyhet ne para nga Ortaku Hasan HAFIZI.

   Pas kryerjes se ketij transaksioni, kapitali i shoqerise behet 65.436.000 Leke (gjashtedhjete e pese milion katerqind e tridhjete e gjashte) i ndare ne 798 kuota me vlere prej 82.000 Leke, secila dhe zoterohet nga ortaket si me poshte ndahet si vijon:

EUROVIA INTERNATIONAL S.A.	409 kuota
Hasan HAFIZI	389 kuota
TOTAL	798 kuota

2. Me qellim qe ndryshimet e mesiperme te pasqyrohen ne statutin e shoqerise ortaket vendosen te bejne ndryshimet e meposhtme ne nenet 14 dhe 15 te statutit:

   Neni 14
   "Kapitali themeltar i shoqerise eshte 65.436.000 leke (gjashtedhjete e pese milion e katerqind e tridhjete e gjashte mije) i ndare ne 798 kuota me vlere 82.000 Leke secila."

Neni 15

Shtohet paragrafi i meposhtem:

"Si rezultat i derdhjes se kontributit ne para nga Ortaku Hasan HAFIZI dhe zmadhimit te kapitalit themeltar ne daten 24 Shtator 2003, kapitali i shoqerise i perbere prej 798 kuota me vlere 82.000 leke secila ndahet ndermjet ortakeve si me poshte vijon:

EUROVIA INTERNATIONAL S.A.	409 kuota ose 51.25 % e kapitalit
Hasan HAFIZI	389 kuota ose 48.75% e kapitalit
Numri total i kuotave	798 kuota ose 100% e kapitalit"

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e kerkeses dhe depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimeve te Asambleve te Ortakeve te ALBAVIA Shpk. date 24.09.2003
- Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri-tjetri, ne kollonen ___, germa___.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Vendimi nr. 19077/6

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 15.06.2004, une, _____, Gjyqtare prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria Albavia Shpk., per regjistrimin e ndryshimeve ne kollonat perkatese te Regjistrit Tregtar dhe depozitimin ne aneksin e tij te Vendimeve te Asamblese se Ortakeve te dates 07.05.2004 si dhe dokumenteve perkatese nga te cilat:

KONSTATOVA

Shoqeria Albavia Shpk., eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 19077, date 19.03.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me date 07.05.2004 Asambleja e Ortakeve te shoqerise Albavia Shpk. ka vendosur:

Te rinovoje per nje periudhe tjeter tre-vjecare e cila perfundon ne vitin 2007, mandatet e Administratoreve te shoqerise ALBAVIA Shpk., si me poshte:

- Z. Jean-Louis Marchand.
- Z. Hasan Hafizi.
- Z. Philippe Peytavin.
- Z. Daniel Roffet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses
- Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimeve te Asambleve te Ortakeve te ALBAVIA Shpk. date 07.05.2004 si dhe te dokumentave perkates.
- Urdherohet zyra e Regjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen 4, germa__, si dhe te behet ndarja nga njeri tjetri me vize te kuqe.

Kunder ketij Vendimi mund te behet Ankim.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 19077/7 VENDIMIT

VENDIM

"I GJYQTARIT TE VETEM"

Sot, me date 04/04/2007 ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane, une J. Qafoku, Gjyqtare e kesaj gjykate, pasi u njoha me kerkesen dhe materialin e paraqitur nga Z. Hasan Hafizi per te depozituar vendimin Asamblese se Pergjithshme mikse te ortakeve te shoqerise "Albavia" sh.p.k, lidhur me ndryshimin e statutit te shoqerise.

KONSTATOVA SE

Ne mbledhjen e dates 22 Shkurt 2007 te Asamblese se Pergjithshme Mikse te ortakeve te Shoqerise "Albavia" sh.p.k te regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin nr 19077, date 19.03.1998 dhe perfaqesuar nga Administratori Z. Hasan Hafizi dhe Eurovia International, perfaqesuar nga Z. Patrick Jutier, u vendos si me poshte vijon:

1. Rinovimi i mandateve te Administratoreve te shoqerise qe mbarojne ne 2007, per nje periudhe 3 vjecare;deri ne vitin 2010; Per Administratoret:
   -Z. Jean-Louis MARCHAND
   -Z.Hasan HAFIZI
   -Z.Philippe PEYTAVIN
   -Z. Daniel ROFFET

2. Ndryshimin e selise qendrore te shoqerise. Selia e re qendrore e shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Sulejman Delvina, Ap 19, Tirane, SHQIPERI
3. Si rrjedhim i vendimit te pare, u vendos modifikimi i nenit 4, fraksion 1 te statutit te shoqerise, si me poshte:

Neni 4

Shoqeria Albavia sh.p.k me seli qendrore ne Tirane, Republika e Shqiperise, ne rrugen "Sulejman Delvina", Apt 19, Tirane.

4. Ortaket i japin te gjithe fuqite Z.Hasan Hafizi, per te kryer, drejtperdrejt ose me delegim, vendimet e kesaj Asambleje.
5. Depozitimi i vendimit te Asamblese se Pergjithshme Mikse te ortakeve te Shoqerise "Albavia" sh.p.k dhe i kerkeses, ne Zyren se Regjistrit Tregtar, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

VENDOSA

1. Pranimin e kerkeses se Z. HASAN HAFIZI per te depozituar ndryshimet perkatese ne shoqeri si me poshte:

- Rinovimi i mandateve te Administratoreve te shoqerise qe mbarojne ne 2007, per nje periudhe 3 vjecare deri ne vitin 2010; Per Administratoret:
  -Z. Jean-Louis MARCHAND
  -Z.Hasan HAFIZI
  -Z.Philippe PEYTAVIN
  -Z. Daniel ROFFET

- Ndryshimin e selise qendrore te shoqerise. Selia e re qendrore e shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Sulejman Delvina, Ap 19, Tirane, SHQIPERI
- Si rrjedhim i vendimit te pare, u vendos modifikimi i nenit 4, fraksion 1 te statutit te shoqerise, si me poshte:

Neni 4

Shoqeria Albavia sh.p.k me seli qendrore ne Tirane, Republika e Shqiperise, ne rrugen "Sulejman Delvina", Apt 19, Tirane.

- Ortaket i japin te gjithe fuqite Z.Hasan Hafizi, per te kryer, drejtperdrejt ose me delegim, vendimet e kesaj Asambleje.
- Depozitimi i vendimit te Asamblese se Pergjithshme Mikse te ortakeve te Shoqerise "Albavia" sh.p.k dhe i kerkeses, ne Zyren se Regjistrit Tregtar, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

2. Urdherimin e zyres se Regjistrit Tregtar te beje ndryshimet ne kolonen perkatese.

3. Ndarjen me vize te kuqe te regjistrimeve nga njeri-tjetri.

Kundra ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

Urdhër regjistrimi

(19077)

1

2 a - "Albavia" Sh.p.k.

b - Adresa: "Sami Frashëri", p. 20/1 kat. Tiranë

c - fushën veprimtarie, konsulenca gjyqësore, ndërtime dhe shpërndarëse ....
Ndërtime repera arsi, pllakime.

ç. 100 000 lekë:

1. Shqipëria Coclery Bouraou dhe asnse. Internacionale 50%

2. Hasan Hafizi 25%

3. Karl Gega Konstruksion 25%

3. Administrim: 1. Hasan Hafizi dhënë 1 (një) vjet, banues Rr. S. Frashëri p. 20/1 kat. I Apt. 17.

2. Valentina Krugër dhënë

3. Jean Louis Marchand

4. Maurice Maisy

4. 10 vjet

AU - 9 fletë

FT - 19 fletë + 1 AU

4-03-98

19-03-98

- Licenca N N. 2846 . dt. 2-3-98

- Prokura për shpenzim Cochery Bourdin Chaussé. Tërmasional prokurën Maurice Moity. dt. 30-01-98. vendosur Je gjyqe konsulatore e Ambasadës shqiptare Paris.

- Procës-Verbal: Këshilli Administrativ, shkëp. Cochery Bourdin. dt 20-01-98

- Regjistrim në regjistrin tregtor Nr. 102.

Prokura LT/GM/AT 043949 02. Nr. 1736. dt. 18-03-98 (Mëkurti)

Prokura Nr. 1735/163 dt. 18-03-98 (Mëkurti)

- Vendim Asamblese e shpenzimi F.G. konsulentëve. dt 18-03-98. (Mëkurti)

- V.G. vetëm dt 18-03-98

Gjykatësi
M. Deda

KONTRATE (AKT THEMELIMI)

Per themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me Ortakeri

"ALBAVIA" SHPK

KAPITULLI I

HYRJE

Ne mbeshtetje dhe pajtim me Legjislacionin Shqiptar, perkatesisht te Ligjeve te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise Nr. 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire dhe te privatizimit", Nr. 7764 date 02.11.1993 "Per Investimet e Huaja", Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregetare", Ne Palet Kontraktuese:

1. **Shoqeria "Cochery Bourdin Chausse International" SA,** Person Juridik i te Drejtes Franceze, me seli ne RUEIL MALMAISON-92565-18, Place de L'Europe, regjistruar ne Regjistrin e Tregtise dhe Shoqerive Tregtare ne NANTERRE, me numrin B 348 866 260, e perfaqesuar nga Z. Maurice MOISY, me Prokure te Posaçme date 30 Janar 1998, leshuar nga Drejtori Kryesor i Shoqerise, Z. Roger MARTIN dhe konfirmuar nga Z. Alain THABEAULT, noter ne Paris, Gjykata e shkalles se dyte e Republikes Franceze si dhe nga Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes Franceze, Dhoma e Tregtise dhe Industrise ne Paris dhe Ambasada Shqiptare ne Paris,

2. Z. **Hasan HAFIZI**, i biri Ramizit, lindur me 11.02.1955 ne Lezhe, banues ne Tirane-Shqiperi me adrese Rruga "Sami Frasheri", Pall. 20/1, Hyrja 1, Apart. 17, Person Fizik, me numer pasaporte 0121999,

3. **Shoqeria "Karl Gega Konstruksion" SHPK**, Person Juridik i te Drejtes Shqiptare, me seli ne SHKODER, Rruga "Marin Barleti", Pall. 173, rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar dhe te Shoqerive Tregtare ne TIRANE, me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 3413/2, date 18.03.1998, e perfaqesuar nga Hasan HAFIZI, me Prokure te Posacme date 20 Mars 1998, leshuar nga Ortaket e Shoqerise dhe e konfirmuar nga noterja Shpresa KURTI, Zyra e Noterise Tirane,

me vullnetin tone te lire dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

VENDOSEM

Sot, me date 20 Mars 1998, ne TIRANE, Republika e Shqiperise, te themelojme nje Shoqeri te Perbashket, ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me Ortakeri per te zhvilluar veprimtari te perbashket ekonomike, industriale, financiare dhe tregetare te emertuar:

"ALBAVIA " SHPK

KAPITULLI II

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ALBAVIA " SHPK do te kete pozite, status dhe aktivitet te percaktuar ligjor te bazuar ne dispozitat ligjore per Shoqerite Tregetare, ne Aktet nenligjore, Aktet e krijimit te Shoqerise dhe ne ato normativa qe bazohen ne praktiken tregetare.
Shoqeria ka statusin e Personit Juridik te se Drejtes Shqiptare.

NENI 2

Shoqeria "ALBAVIA " SHPK e ka seline e vet ne TIRANE, Republika e Shqiperise, ne adresen Rruga Sami FRASHERI, Pall. 20/1, Shkalla e pare, Apartamenti 17.
Shoqeria, gjate realizimit te aktivitetit te saj, mund te çele Dege, Filiale apo Zyra Perfaqesimi brenda ose jashte Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ose te vendit te huaj ku ato çelen.

NENI 3

Shoqeria themelohet dhe do te funksionoje per te ushtruar veprimtari me objektiv te pergjithshem ndertimet ne te gjitha fushat.

Shoqeria ka per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

1. **Konsulence, projektime, ndertime dhe supervizione ne fushen e ndertimeve rrugore si me poshte:**
   - **Ndertim rrugesh te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj).**
   - **Ndertim pistash e aeroportesh.**
   - **Ndertim veshjesh asfaltike e shtresash rrugore.**
   - **Punime dherash, sistemime, terracime terrenesh, etj.**
   - **Punime te rikonstruksionit, mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijezimit te rrugeve.**
   - **Ndertime te veprave te artit rrugore e hekurudhore te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, viadukte, tunele etj).**
   - **Punime topogjeodezike, gjeologjike dhe analizash laboratorike per punimet rrugore.**

2. **Administrim dhe shfrytezim te guroreve, kavove te zhavorit, karierave te rerave bituminoze, impianteve te betonit, impianteve te perzierjeve bituminoze, impianteve te prodhimit te inerteve etj, perfshire dhe tregtimin e materialeve teknollogjike te prodhuar si dhe materialeve te ndertimit, industriale etj.**

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj dhe ne aktivitete te tjera plotesuese qe lidhen direkt apo indirekt me fushen e ndertimeve si me poshte:

- Konsulence, projektime, ndertime dhe supervizion ne fushat e ndertimeve industriale, hidroteknike, civile, urbanistike, turizmit, ushtarake, objekte kulti, kulturore, sportive etj., perfshire dhe restaurimin, rikonstruksionin e mirembajtjen e veprave ekzistuese.
- Konçensione dhe investime ne te gjitha fushat.
- Importim dhe eksportim te te gjitha llojeve te materialeve dhe mallrave, paisjeve dhe makinerive te ndryshme.
- Levrim te teknikave te ndertimit sipas teknollogjive bashkekohore.
- Aktivitet marketingu dhe kualifikim profesional.
- Perfaqesime, ndermjetesime, kooperime dhe tranzitime per probleme te karakterit te ndryshem per vendas dhe te huaj.
- Shoqeria mund te krijoje per qellime shfrytezimi ambiente çlodhese, pune dhe sherbimi te te gjitha natyrave.
- Shoqeria eshte e organizuar te ushtroje veprimtari ne te gjitha drejtimet, ne kufijte qe e lejon ligji, qe perfshihen ne natyren juridiko-profesionale dhe perputhen me objektin e shoqerise.

Shoqeria mund te lidhe kontrata per sa eshte percaktuar ne paragrafet e meparshme, te hyje ne marredhenie te lira bankare dhe financiare per shfrytezimin e aftesive te saj, kur keto marredhenie Shoqeria i shikon me leverdi per realizimin e qellimit social te objektit te veprimtarise dhe per te siguruar fitime.

NENI 4

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e nevojshem duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit. Ajo gezon te gjitha te drejtat ne veprimtarine juridike qe kryen me persona te trete.

KAPITULLI III

KUSHTET EKONOMIKE DHE BUXHETI

NENI 5

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 000 (Njeqindmije) Leke.
Kapitali i mesiperm ndahet si me poshte:
1. "Cochery Bourdin Chausse International" SA si Ortak ne Shoqeri kontribuon me kapitalin prej 50000 (Pesedhjetmije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 50 % (pesedhjete perqind),

2. Z. Hasan HAFIZI, si Ortak ne Shoqeri kontribon me kapitalin prej 25000 (njezetepesemije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 25% (njezetepese perqind),

3. "Karl Gega Konstruksion" SHPK, si Ortak ne Shoqeri kontribuon me kapitalin prej 25000 (njezetepesemije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 25% (njezetepese perqind).

Kontributet e Ortakeve regjistrohen ne Librin e llogarive dhe Regjistrin e Shoqerise.
Shumat ne para te Kapitalit Themeltar te Shoqerise jane depozituar ne Banken Tregetare Shqiptare.
Shtimi i kontributeve te Ortakeve ne para apo natyre nuk eshte i kufizuar.

NENI 6

Shoqeria pergjigjet vetem brenda Kapitalit te saj Themeltar. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e Ortakeve dhe as keta te fundit nuk mbajne pergjegjesi personalisht per detyrimet e Shoqerise si dhe nuk perballojne humbjet e saj tej kuotes se derdhur prej tyre per themelimin e Shoqerise.
Shoqeria gjithashtu nuk pergjigjet per detyrimet e Shtetit Shqiptar dhe anasjelltas.

NENI 7

Shoqeria fillon veprimtarine e saj nga data e regjistrimit ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe Zyren e Tatim Taksave.

NENI 8

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise dhe investimet e Ortakut te Huaj mbrohen nga shteti, i cili i garanton atij dhe Shoqerise te njejtin trajtim dhe te njejtat te drejta qe Ligji u njeh Personave Juridike Shqiptare.

NENI 9

Shoqeria ne kushtet ekonomike te krijuara dhe per zhvillimin e veprimtarise se saj, per çdo vit harton e nderton buxhetin e saj. Te ardhurat qe realizon dhe shpenzimet qe ben Shoqeria gjate veprimtarise financiare vjetore, do te pasqyrohen ne

Bilancin vjetor te Shoqerise sipas Ligjit Nr.7661 dt.19.01.1993 "Per kontabilitetin", duke iu pergjigjur ne menyre korrekte detyrimeve ligjore dhe sistemit fiskal.

NENI 10

Shoqeria e realizon fitimin gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, ne perputhje me Kontraten, Statutin dhe Legjislacionin Shqiptar ne fuqi.
Fitimi neto i realizuar nga Shoqeria, pasi te jene zbritur shumat qe u takojne detyrimeve fiskale, kostove faktike, fondit rezerve apo zgjerimit te metejshem te aktivitetit, u ndahet Ortakeve perpjestimisht me kuotat e tyre.
Fitimi dhe shperblimet e tjera te Ortakut Francez mund te transferohen lirisht ne valute te konvertueshme ne France, pasi te jene paguar taksat ne Shqiperi konform Legjislacionit.

NENI 11

Llogarite vjetore per efekt te Bilancit do te mbyllen brenda tremujorit te pare te vitit pasardhes. Vit i ushtruar financiar do te jete viti kalendarik, perjashtimisht viti i pare financiar do te mbyllet me 31 Dhjetor 1998.

NENI 12

Shoqeria ne perputhje me interesat e saj dhe Ligjin e kontabilitetit ka te drejte qe çdo vit te krijoje fonde rezerve dhe fonde te reja financimi e zhvillimi.
Shoqeria do mbaje llogarine rrjedhese te saj ne Banken Tregtare Shqiptare, Banken e Kursimeve dhe Banka te tjera qe percaktohen ne marreveshje te perbashket mes Ortakeve.
Per pasqyrimin e gjendjes se llogarive, Shoqeria do te mbaje gjithe dokumentacionin e nevojshem te percaktuar ne Rregulloren e Brendeshme te saj.

KAPITULLI IV

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

NENI 13

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ALBAVIA" SHPK do te organizohet, drejtohet dhe funksionoje ne baze te Ligjit perkates, Statutit te saj dhe Rregullores se Brendeshme te Shoqerise.

NENI 14

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- Asamblea e Ortakeve
- Administratoret dhe / ose Administratori i vetem/
- Ekspertet kontabel te autorizuar.

Menyra e perberjes, funksionimit dhe detyrat e te drejtat e tyre percaktohen ne menyre te detajuar ne Statutin e Shoqerise.

NENI 15

Administratore te Shoqerise "ALBAVIA" SHPK do te jene:

1. Z. Hasan HAFIZI
2. Zj. Valentina KRUJA
3. Z. Jean Louis MARCHAND
4. Z. Maurice MOISY

KAPITULLI V

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 16

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike pa nderprerje mbi 10 vjet. Kjo periudhe mund te zgjatet ose shkurtohet me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 17

Ortaket detyrohen reciprokisht te ruajne sekretin e dokumentacionit te Shoqerise qe ka te beje me informacionin,

teknollogjine dhe pervojen e akumuluar prej partnereve apo Shoqerise si dhe te dhenat e ndryshme qe i perkasin asaj. Ata marrin te gjitha masat e duhura per te shmangur publikimin e tyre, qofte edhe pjeserisht.
Ortaket jane pergjegjes per demet qe mund te rrjedhin nga mosrespektimi i ketyre detyrimeve.

NENI 18

Per disiplinimin e jetes organizative dhe veprimtarise ekonomike financiare te Shoqerise, te gjithe personat e punesuar ne te detyrohen te respektojne dhe te zbatojne detyrimet ligjore, Aktin e Themelimit, Statutin, Rregulloren e Brendeshem te Shoqerise, Statusin e personelit, te drejtat e detyrat qe sanksionohen ne keto dokumenta dhe ne Kontraten e punes. Ata jane te detyruar te ruajne sekretin profesional dhe organizativ te Shoqerise.

NENI 19

Kjo Kontrate (Akt Themelimi) si dhe dokumentat perkatese bashkalidhur perfaqesojne vullnetin e plote te paleve. Ajo mund te modifikohet me nje marreveshje te re me shkrim, duke njoftuar nje vendim te tille 6 muaj perpara.

NENI 20

Mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj Kontrate midis paleve ose mosmarreveshjet qe mund te lindin dhe qe mund te prekin funksionimin dhe mireadministrimin e Shoqerise, Ortaket zotohen se do t'i zgjidhin me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, atehere çeshtja do te kaloje ne Gjykaten kompetente nga pala e interesuar ne perputhje me rregullat proceduriale te parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

NENI 21

Dispozita te hollesishme per Shoqerine percaktohen ne Statutin e saj qe i bashkalidhet kesaj Kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

NENI 22

Kjo Kontrate (Akt Themelimi) hartohet ne 8 (tete) ekzemplare origjinale per t'iu shperndare Organeve kompetente, Paleve

Kontraktuese dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

NENI 23

Kontrata, pasi u lexua, u gjet e rregullt dhe firmoset pa asnje verejtje nga Ortaket. Kontrata hyn ne fuqi siç eshte percaktuar ne paragrafet e meparshem dhe sipas rregullave ne fuqi.

Kontrata u perpilua ne Tirane, me 20 Mars 1998 dhe permban 23 (njezetetre) Nene ne 9 (nente) faqe. Secili nga Ortaket merr nga nje ekzemplar origjinal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 1375 Rep.
Nr. 249 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 19.03.1998 (nentedhjete e tete) u paraqiten para Meje Monushope Shaska notere ne kete qytet Z. Hasan Ramiz HAFIZI ,Sh.p.k. "KARL GEGA KONSTRUKSION" e ortakeve Hartian Sallaku, Luan Kopliku, Hasan Hafizi dhe Shkelqim Rakipaj perfaqesuar me prokure nga Z. Hasan HAFIZI dhe Sh.A. " COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAAL" perfaqesuar nga Z. Maurice MOISY te gjithe madhore me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova ne dokumentat perkatese te cilet me vullnetin e tyre te lire e te plote me deklaruan permbajtjen e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Sh.p.k. me ortakeri me emertimin "ALBAVIA" duke nenshkruar para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

Monushope Shaska

PULLE TAKSE
50 LEKE
R.SHQIPERISE

STATUTI

Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me Ortakeri

"ALBAVIA" SHPK

KAPITULLI I

HYRJE

Ne mbeshtetje dhe pajtim me Legjislacionin Shqiptar, perkatesisht te Ligjeve te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise Nr. 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire dhe te privatizimit", Nr. 7764 date 02.11.1993 "Per Investimet e Huaja", Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregetare", Ne Palet Kontraktuese:

1. **Shoqeria "Cochery Bourdin Chausse International" SA,** Person Juridik i te Drejtes Franceze, me seli ne RUEIL MALMAISON-92565-18, Place de L'Europe, regjistruar ne Regjistrin e Tregtise dhe Shoqerive Tregtare ne NANTERRE, me numrin B 348 866 260, e perfaqesuar nga Z. Maurice MOISY, me Prokure te Posaçme date 30 Janar 1998, leshuar nga Drejtori Kryesor i Shoqerise, Z. Roger MARTIN dhe konfirmuar nga Z. Alain THABEAULT, noter ne Paris, Gjykata e shkalles se dyte e Republikes Franceze si dhe nga Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes Franceze, Dhoma e Tregtise dhe Industrise ne Paris dhe Ambasada Shqiptare ne Paris,

2. Z. **Hasan HAFIZI,** i biri Ramizit, lindur me 11.02.1955 ne Lezhe, banues ne Tirane-Shqiperi me adrese Rruga "Sami Frasheri", Pall. 20/1, Hyrja 1, Apart. 17, Person Fizik, me numer pasaporte 0121999,

3. **Shoqeria "Karl Gega Konstruksion" SHPK**, Person Juridik i te Drejtes Shqiptare, me seli ne SHKODER, Rruga "Marin Barleti", Pall. 173, rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar dhe te Shoqerive Tregtare ne TIRANE, me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 3413/2, date 18.03.1998, e perfaqesuar nga Hasan HAFIZI, me Prokure te Posacme date 20 Mars 1998, leshuar nga Ortaket e Shoqerise dhe e konfirmuar nga noterja Shpresa KURTI, Zyra e Noterise Tirane,

me vullnetin tone te lire dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

VENDOSEM

Te themelojme nje Shoqeri Tregtare, njesi me vete, te pavarur, ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar, qe do te administrohet, drejtohet, organizohet dhe do te funksionoje ne regjimin e prones private, mbi bazen e parimeve te ekonomise se tregut dhe kushteve te konkurences se lire, per te siguruar fitime.

Bazuar ne kete vendim dhe ne Aktin e Themelimit, Ortaket

HARTOJNE

Statutin e Shoqerise Tregetare, ne pronesi private, ne formen e **Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "ALBAVIA" SHPK**

KAPITULLI II

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria Tregetare "ALBAVIA" SHPK, qe me poshte do te quhet **"Shoqeria"**, krijohet ne perputhje me dispozitat ligjore per Shoqerite Tregetare, me Aktet nenligjore qe lidhen me praktiken tregetare dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise.

NENI 2

Statuti i Shoqerise, permban dhe rregullon poziten dhe statusin juridik te saj, poziten dhe marredheniet e Ortakeve, pjesemarrjen e Shoqerise si Person Juridik ne qarkullimin juridiko-civil dhe ne marredheniet me te tretet, objektin e Shoqerise, kushtet ekonomike, administrimin dhe organizimin e Shoqerise.

NENI 3

Shoqeria do te realizoje objektin e veprimtarise se saj te vendosur ne Kontraten (Akt-Themelimi) dhe te sanksionuar ne kete Statut, ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj konform Legjislacionit Shqiptar ne fuqi dhe Legjislacionit perkates te vendeve te huaja.

NENI 4

Shoqeria "ALBAVIA " SHPK e ka seline e vet ne TIRANE, Republika e Shqiperise, ne adresen Rruga Sami FRASHERI, Pall. 20/1, Shkalla e pare, Apartamenti 17.
Shoqeria, gjate realizimit te aktivitetit te saj, mund te çele Dege, Filiale apo Zyra Perfaqesimi brenda ose jashte Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ose te vendit te huaj ku ato çelen.

NENI 5

Shoqeria ka statusin e Personit Juridik te se Drejtes Shqiptare. Zotesine juridike per te vepruar dhe kapacitetin profesional, Shoqeria i fiton me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar te Gjykates Tirane dhe Organet Tatimore.

NENI 6

Me cilesine e Personit Juridik me vehte dhe te pavarur, Shoqeria ka vulen, llogarine rrjedhese (ne leke dhe devize) dhe investigimin e saj.
Shoqeria ka te gjitha kondicionet per te ushtruar veprimtari ne baze te Ligjit, te percaktuara me vullnetin e Ortakeve.

NENI 7

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike pa nderprerje mbi 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykate dhe Organin Tatimor.

NENI 8

Afati i vendosur ne Aktin e Themelimit dhe i sanksionuar ne kete Statut per ekzistencen dhe kohezgjatjen e veprimtarise se Shoqerise, nuk e ndalon Asamblene e Ortakeve, qe te marre vendim, per te pushuar apo zgjatur afatin e veprimtarise se saj.

NENI 9

Objekti i veprimtarise

Shoqeria themelohet dhe do te funksionoje per te ushtruar veprimtari me objektiv te pergjithshem ndertimet ne te gjitha fushat.

Shoqeria ka per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

1. Konsulence, projektime, ndertime dhe supervizione ne fushen e ndertimeve rrugore si me poshte:
   - Ndertim rrugesh te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj).
   - Ndertim pistash e aeroportesh.
   - Ndertim veshjesh asfaltike e shtresash rrugore.
   - Punime dherash, sistemime, terracime terrenesh, etj.
   - Punime te rikonstruksionit, mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijezimit te rrugeve.
   - Ndertime te veprave te artit rrugore e hekurudhore te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, viadukte, tunele etj).
   - Punime topogjeodezike, gjeologjike dhe analizash laboratorike per punimet rrugore.

2. Administrim dhe shfrytezim te guroreve, kavove te zhavorit, karierave te rerave bituminoze, impianteve te betonit, impianteve te perzierjeve bituminoze, impianteve te prodhimit te inerteve etj, perfshire dhe tregtimin e materialeve teknollogjike te prodhuar si dhe materialeve te ndertimit, industriale etj.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj dhe ne aktivitete te tjera plotesuese qe lidhen direkt apo indirekt me fushen e ndertimeve si me poshte:

- Konsulence, projektime, ndertime dhe supervizion ne fushat e ndertimeve industriale, hidroteknike, civile, urbanistike, turizmit, ushtarake, objekte kulti, kulturore, sportive etj., perfshire dhe restaurimin, rikonstruksionin e mirembajtjen e veprave ekzistuese.
- Konçensione dhe investime ne te gjitha fushat.
- Importim dhe eksportim te te gjitha llojeve te materialeve dhe mallrave, paisjeve dhe makinerive te ndryshme.
- Levrim te teknikave te ndertimit sipas teknollogjive bashkekohore.
- Aktivitet marketingu dhe kualifikim profesional.
- Perfaqesime, ndermjetesime, kooperime dhe tranzitime per probleme te karakterit te ndryshem per vendas dhe te huaj.
- Shoqeria mund te krijoje per qellime shfrytezimi ambiente çlodhese, pune dhe sherbimi te te gjitha natyrave.
- Shoqeria eshte e organizuar te ushtroje veprimtari ne te gjitha drejtimet, ne kufijte qe e lejon ligji, qe perfshihen ne natyren juridiko-profesionale dhe perputhen me objektin e shoqerise.

Shoqeria mund te lidhe kontrata per sa eshte percaktuar ne paragrafet e meparshme, te hyje ne marredhenie te lira bankare dhe financiare per shfrytezimin e aftesive te saj, kur keto marredhenie Shoqeria i shikon me leverdi per realizimin e qellimit social te objektit te veprimtarise dhe per te siguruar fitime.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e nevojshem duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit. Ajo gezon te gjitha te drejtat ne veprimtarine juridike qe kryen me persona te trete.

KAPITULLI III

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 11

Ortaket kane keto te drejta kryesore, te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asamblea e Ortakeve:

- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se Shoqerise ne perputhje me Aktin Themelues (Kontraten) dhe me kete Statut, vete ose nepermjet perfaqesuesve te autorizuar te tyre.
- Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne çdo forme dhe sasi qofte, siç parashikohet ne Aktin Themelues dhe kete Statut.
- Te marrin pjese ne Organet e Shoqerise qe jane ose qe mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tyre ose vete.
- Te kerkojne dhe t'i jepen te gjitha informacionet qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregetare te Shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te Shoqerise (Bilancet, Llogarite ekonomike, Librat e Shoqerise etj.)
- Te bejne propozime dhe t'i paraqesin ato per shqyrtim para Organeve te Shoqerise.
- Te heqin dore nga Shoqeria duke ua ofruar kuotat e tyre Ortakut tjeter. Kur ky i fundit heq dore nga e drejta e parablerjes, Ortaku doreheqes ka te drejten t'ia transferoje kuoten e vet te treteve, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

NENI 12

Ortaket kane keto detyra kryesore:

- Te depozitojne kuoten e tyre ne Kapitalin Themeltar, ne perputhje me Aktin Themelues (Kontraten) dhe kete Statut.
- Te marrin pjese ne administrimin e Shoqerise nepermjet Organeve te krijuara prej tyre, vete ose nepermjet perfaqesuesve qe caktojne ata.
- T'i japin Shoqerise informacionin e nevojshem qe ka te beje me veprimtarine e saj.
- T'i japin Shoqerise ndihmen e nevojshme me qellim qe te arrihet çdo objektiv qe ka lidhje me objektin e veprimtarise se Shoqerise.

KAPITULLI IV

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 13

Shoqeria eshte krijuar me mjetet financiare te Ortakeve, sipas kontributeve perkatese paqyruar ne Nenin 15 te ketij Statuti, shume e cila perben Kapitalin Themeltar te vene ne dispozicion dhe te depozituar, me themelimin e Shoqerise, ne Degen e Bankes Tregetare Tirane ne emer te Shoqerise.

NENI 14

Kapitali Themeltar i Shoqerise "ALBAVIA" SHPK eshte 100 000 (njeqindmije) leke, ndare ne 100 (njeqind) pjese (kuota) me vlere 1000 (njemije) leke secila, plotesisht te shlyera.
Kjo vertetohet me Mandatin e Arketimit te leshuar nga Dega e Bankes Tregtare Tirane.

NENI 15

Kapitali Themeltar eshte i ndare si me poshte:

1. "Cochery Bourdin Chausse International" SA si Ortak ne Shoqeri kontribuon me kapitalin prej 50000 (Pesedhjetmije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 50 % (pesedhjete perqind),

2. Z. Hasan HAFIZI, si Ortak ne Shoqeri kontribon me kapitalin prej 25000 (njezetepesemije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 25% (njezetepese perqind),

3. "Karl Gega Konstruksion" SHPK, si Ortak ne Shoqeri kontribuon me kapitalin prej 25000 (njezetepesemije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 25% (njezetepese perqind).

Kontributet e Ortakeve regjistrohen ne Librin e Llogarive dhe Regjistrin e Shoqerise.
Shtimi i kontributeve te Ortakeve ne para apo natyre nuk eshte i kufizuar.

NENI 16

Tere kapitali i Shoqerise zoterohet nga Ortaket. Ata jane te vetmit pronare dhe vetem ata kane te drejte te perdorin kete pasuri, ne emer dhe ne interes te Shoqerise.

NENI 17

Secili nga Ortaket gezon te drejten e doreheqjes nga Shoqeria, duke e motivuar vendimin e tij perpara Asamblese se Ortakeve, sipas Nenit 11 te ketij Statuti.
Doreheqja eventuale nuk e liron Ortakun doreheqes nga detyrimet e tij te meparshme ndaj Shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e kesaj te fundit ndaj Ortakut doreheqes.

NENI 18

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaket kane te drejten e parablerjes te kuotave te Ortakut doreheqes.
Kut Ortaket heqin dore nga e drejta e parablerjes, Ortaku doreheqes ka te drejten t'ia transferoje kuoten e vet te treteve, ne perputhje me Nenin 20 te ketij Statuti dhe Dispozitat e Legjislacionit Shqiptar.

NENI 19

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferushme me rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

NENI 20

Pjeset e Kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri, vetem me miratimin e shumices se Ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te Kapitalit Themeltar.
Ne rast se Shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.
Ne rast se Shoqeria refuzon te jape miratimen e transferimit, Ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te Kapitalit

Themeltar me vleren e percaktuar sipas rregullave te Nenit 11 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

NENI 21

Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themeltar duhet te vertetohen me nje Akt Noterial.
Shoqeria ose te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo t'i behen te ditura asaj.

NENI 22

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj (Kapitalin Themeltar); ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e Ortakeve dhe as keta te fundit nuk mbajne pergjegjesi personalisht per detyrimet e Shoqerise si dhe nuk perballojne humbjet e saj tej kuotes se derdhur prej tyre per themelimin e Shoqerise.
Shoqeria gjithashtu nuk pergjigjet per detyrimet e Shtetit Shqiptar dhe anasjelltas.
Pjesemarrja ne Shoqeri nuk i pengon Ortaket te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

NENI 23

Ne rast se kapitalet e veta te Shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e Kapitalit Themeltar, Ortaket vendosin, brenda 4 muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne kete humbje, mbi mundesine e prishjes se parakohshme te Shoqerise, duke zbatuar klauzolat e Nenit 72 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

NENI 24

Ne veprimtarine e saj Shoqeria do te mbeshtetet ne burimet e veta, ne shtesat eventuale qe mund te bejne Ortaket, ne fitimet qe do te realizoje Shoqeria, ne fondet e perkoheshme qe ajo mund te siguroje (Hua dhe Kredi) nga Institucionet Financiare dhe Banka te ndryshme, duke mobilizuar dhe aktivizuar edhe mjete te te treteve ne veprimtarine e saj.

KAPITULLI V

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

NENI 25

Veprimtaria e Shoqerise realizohet ne baze te leverdishmerise ekonomike dhe pasqyrohet ne Bilancin e saj.
Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurise ne emer te vet, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj.

NENI 26

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Gjykate dhe Organet Tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 1998.
Ne rastet kur Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj, viti financiar mbaron ne daten e shpalljes se mbylljes se Shoqerise.

NENI 27

Shoqeria e realizon veprimtarine e vet financiare ne perputhje me Planet Ekonomiko-Financiare dhe Programet Ekonomike vjetore.
Programet ekonomiko-financiare duhet te parashikojne aktivin dhe pasivin te shprehura ne monedhe te konvertueshme. Ato duhet te paraqesin nje parashikim te fitimeve, te kostos dhe ne çdo rast te rezultateve ekonomike. Kontabiliteti dhe llogaria ekonomike (Bilanci Shoqerise) do te shkruhen dhe do te mbahen ne Shqiperi, duke i dhene Ortakut te Huaj informacionin e nevojshem sipas kerkesave te tij. Rezultatet financiare te veprimtarise se Shoqerise do te percaktohen ne baze te Bilancit vjetor, duke iu pergjigjur ne menyre korrekte detyrimeve ligjore dhe sistemit fiskal. Konvertimi i monedhes shqiptare ne devize te huaj dhe anasjelltas do te behet me kursin e kembimit te Bankes Shqiperise.
Llogarite vjetore, per efekt te Bilancit, do te mbyllen brenda tremujorit te pare te vitit pasardhes.

NENI 28

Shoqeria ne perputhje me interesat e saj dhe Ligjin e Kontabilitetit ka te drejte, qe çdo vit, te krijoje fonde rezerve dhe fonde te reja financimi dhe zhvillimi.
Shoqeria do mbaje llogarine rrjedhese te saj ne Banken Tregtare Shqiptare, Banken e Kursimeve dhe ne Banka te tjera qe percaktohen ne marreveshje te perbashketa mes Ortakeve.
Per pasqyrimin e gjendjes se llogarive, Shoqeria do te mbaje gjithe dokumentacionin e nevojshem te percaktuar ne Rregulloren e Brendeshme te saj.

NENI 29

Shoqeria e realizon fitimin gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, ne perputhje me Kontraten, Statutin dhe Legjislacionin Shqiptar ne fuqi.
Fitimi neto i realizuar nga Shoqeria, pasi te jene zbritur shumat qe u takojne detyrimeve fiskale, kostove faktike, fondit rezerve apo zgjerimit te metejshem te aktivitetit, u ndahet Ortakeve perpjestimisht me kuotat e tyre.
Fitimi dhe shperblimet e tjera te Ortakut Francez mund te transferohen lirisht ne valute te konvertueshme ne France, pasi te jene paguar taksat ne Shqiperi konform Legjislacionit.

NENI 30

Bilanci vjetor i Shoqerise, Inventari i pasurise, Raporti i aktivitetit financiar i hartuar nga Administratoret si dhe Raporti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar, miratohen nga Asamblea e Ortakeve, brenda nje afati 6 mujor nga data e mbylljes se vitit financiar.

KAPITULLI VI

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 31

Shoqeria "ALBAVIA" SHPK organizohet, drejtohet dhe funksionon ne baze te dispozitave ligjore per Shoqerite Tregetare, Statutit dhe Rregullores Brendeshme te Shoqerise, si dhe te akteve nenligjore qe lidhen me praktiken tregetare.

NENI 32

Organet Drejtuese

Organet drejtuese te Shoqerise jane:
- Asamblea e Ortakeve
- Administratoret dhe / ose Administratori i vetem/
- Ekspertet kontabel te autorizuar.

NENI 33

Asamblea e Ortakeve

Organi me i larte vendimor i Shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve, ne te cilin marrin pjese me te drejte vote, perpjestimisht me kuoten e Kapitalit Themeltar, secili nga Ortaket.
Asamblea eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme. Ajo kryesohet nga nje anetar i zgjedhur nga Ortaket. Kryetari emeron nje sekretar qofte dhe jo Ortak.

NENI 34

Asamblea e Ortakeve drejton veprimtarine e Shoqerise nepermjet mbledhjeve dhe vendimeve qe merren ne te.
Vendimet e Asamblese, kur jane konform Ligjit dhe dispozitave te Statutit te Shoqerise, jane te detyrueshme per te gjithe Ortaket dhe Administratoret e Shoqerise.

NENI 35

Asamblea thirret ne menyrat dhe afatet ligjore, te cilat parashtrohen ne kete Statut dhe Rregulloren e Brendeshme te Shoqerise.

NENI 36

Asamblea e zakoneshme

Asamblea e zakoneshme e Ortakeve gjykon dhe vendos per çeshtje te tilla si me poshte:
- Per miratimin ose jo te Bilancit vjetor.
- Per emerimin ose zevendesimin dhe shperblimin e Administratorit te vetem ose te Administratoreve.
- Per direktivat strategjike per zhvillimin e veprimtarise se Shoqerise.

- Per krijimin dhe mbylljen e Degeve, Filialeve apo Zyrave te Perfaqesimit ne Republiken e Shqiperise apo vende te tjera.
- Per mundesine e riinvestimit te fitimeve te saj ne teritorin e Republikes se Shqiperise apo jashte saj, pasi te jene parashtruar nga Administratoret.
- Per emerimin ose zevendesimin dhe shperblimin e Ekspertet Kontabel te Autorizuar.
- Per miratimin ose jo te Raporteve vjetore te Administratorit, Ekspertit Kontabel si dhe raporteve te tjera ekonomiko-financiare qe parashikon ligji.
- Per menyren e shperndarjes se fitimit dhe planifikimin e kuotave per zhvillimin ekonomiko-financiar te Shoqerise si dhe per çeshtje te tjera qe nuk bien ndesh me Ligjin perkates.

Asamblea e zakoneshme thirret se paku nje here ne vit me paralajmeim me shkrim duke perfshire ketu vendin e diten, derguar me leter rekomande me pergjigje ne adresen qe shenohet ne Librat e Ortakeve. Asamblea e Zakonshme vendos me shumice votash.
Çdo Ortak mund te perfaqesohet edhe nga persona te tjere te paisur me Prokure te veçante.
Proçes verbalet e Asamblese se Zakoneshme redaktohen nga sekretari i Asamblese dhe nenshkruhen nga Ortaket pjesemarres.
Asamblea Zakoneshme mund te jete plotesisht e vlefshme edhe pa paralajmerim, me kusht qe te jete i pranishem i gjithe kapitali i Shoqerise nepermjete perfaqesuesve te vet.

NENI 37

Asamblea e Jashtezakonshme

Asamblea e Jashtezakonshme e Ortakeve gjykon dhe vendos per çeshtje te tilla si me poshte:
- Ndryshimet ne Statut dhe ne Kontraten (Akt-Themelimi).
- Transformimin e Shoqerise nga SH.P.K ne forma te tjera shoqerish.
- Shtimin ose pakesimin e Kapitalit Themeltar.
- Zgjatjen ose pakesimin e kohezgjatjes se veprimtarise se Shoqerise
- Transferimin e kuotave te Kapitalit Themeltar ndermjet Ortakeve apo te treteve.

Asamblea e Jashtezakonshme i merr vendimet e saj me nje shumice votash prej 3/4 e kuotave te perfaqesuara nga Ortaket.

NENI 38

Ne proçes-verbalet e Asamblese se Zakoneshme dhe te Jashtezakoneshme kur nje Ortak e kerkon, duhet te pasqyrohen deklaratat e tij.
Proçes-verbalet e mbledhjeve te Asambleve mbahen ne gjuhet shqip dhe frengjisht ne vlere te barabarte.

NENI 39

Administratoret

Organi administrativ i Shoqerise jane Administratoret (ose Administratori i vetem) te cilet emerohen dhe konfirmohen ne detyren e tyre nga Asamblea e Ortakeve per nje periudhe 3 vjeçare me te drejte riperseritje.
Administratoret mund te zgjidhen edhe jashte bashkesise se Ortakeve. Administratoreve u njihen te gjitha kompetencat per administrimin e Shoqerise.

NENI 40

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret jane kompetente te ushtrojne çdo veprimtari ne emer dhe per llogari te Shqiperise, ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky Statut ia njeh ekskluzivisht Asamblese se Ortakeve.
Administratoret jane personalisht pergjegjes kundrejt Shoqerise dhe te treteve per mosrespektimin e ligjeve, te Statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.
Kompetencat eskluzive te Administratoreve jane si vijon:

- Te organizojne veprimtarine e Shoqerise me qellim qe te realizohen programet e saj.
- Te sigurojne administrimin e Shoqerise.
- Te perfaqesojne Shoqerine ne mardhenie me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se Shoqerise, me perjashtim te çeshtjeve qe ligji dhe ky Statut i lene ne kompetence te Asamblese se Ortakeve.
- Te siguroje nje zbatim te drejte dhe te sakte te vendimeve te Asamblese Ortakeve.

- Te perfaqesojne Shoqerine perpara autoriteteve gjyqesore, arbitrale dhe administrative ndaj te treteve.
- Te pergatisin raportin mbi administrimin e Shoqerise si dhe inventaret dhe kontabilitetin vjetor.
- Te paraqesin perpara Asamblese se Ortakeve raportin e realizimit te objektivave te Shoqerise.
- Te administroje e drejtoje pasurine e mjetet financiare te Shoqerise brenda caqeve te caktuara nga Asamblea e Ortakeve.
- Te leshoje Prokura per nenpunesit e Shoqerise dhe pergjithesisht per te tretet.

Administratoret (kur jane disa) do te veprojne ne kuadrin e kompetencave te mesiperme gjithnje bashkarisht me nenshkrimin e perbashket e se paku te dy prej tyre.

NENI 41

Marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe nje prej Administratoreve ose Ortakeve te saj rregullohen sipas klauzolave te Nenit 51 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

NENI 42

Administratore te Shoqerise "ALBAVIA" SHPK do te jene:
1. Z. Hasan HAFIZI
2. Zj. Valentina KRUJA
3. Z. Jean Louis MARCHAND
4. Z. Maurice MOISY

NENI 43

Eksperti Kontabel i Autorizuar

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te Shoqerise dhe te Filialeve te saj, emerohet nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i cili ngarkohet dhe revokohet nga Asamblea e Zakoneshme e Ortakeve, qe perfaqesojne nje vlere me te madhe se 1/2 e Kapitalit Themeltar per nje periudhe 2 vjeçare me mundesi riperseritjeje.
Eksperti kontabel i Autorizuar nuk duhet te beje pjese ne asnje rast ne Shoqerine e themeluar dhe ne Filialet e saj.

KAPITULLI VII

MARREDHENIET E PUNES

NENI 44

Marredheniet e punes ne Shoqeri, Dege e Filialet e saja, rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e Shoqerise, Legjislacionin Shqiptar dhe kete Statut, nepermjet Kontrates se Punes.

NENI 45

Punesimi i punonjesve ne Shoqeri behet mbi bazen e Kontrates Kolektive te punes.
Ne Kontraten e Punes rregullohen keto çeshtje:

- Kushtet dhe menyra e marredhenieve te punes.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.
- Kohezgjatja e punes, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor dhe festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe trajtimi i punonjesve.
- Pushimi dhe mungesat, detyrimet e punonjesve dhe pergjegjesite e tyre ne zbatimin e detyrave te punes.
- Nderprerja e marredhenieve te punes.
- Pagesat, shperblimet dhe honoraret.

Tipi i Kontrates Kolektive miratohet nga Asamblea e Ortakeve.

NENI 46

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve te saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 47

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise mes saj dhe te punesuarve dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

KAPITULLI VIII

PUSHIMI I VEPRIMTARISE

NENI 48

Veprimtaria e Shoqerise pushon me mbarimin e afatit te caktuar ne Aktin Themelues (Kontrate), me perjashtim te rasteve kur ky afat shtyhet.
Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj para afatit me kerkesen e njerit prej Ortakeve dhe me vendim te Asamblese Jashtezakonshme te Ortakeve.

NENI 49

Shoqeria shperndahet:
- Me mbarimin afatit te kohezgjatjes se saj.
- Ne rast se nuk ka mundesi qe te realizohet objekti i Shoqerise.
- Me miratimin e te gjithe Ortakeve.

NENI 50

Likuidimi i Shoqerise behet sipas rregullave te Legjislacionit ne fuqi ne momentin e likuidimit.
Kur shperndahet Shoqeria:
- Asamblea e Jashtezakoneshme e Ortakeve emeron Komisionin e Likuidimit, qe paraqet Bilancin e likuidimit, ne baze te te cilit Shoqeria pushon se ekzistuari.
- Pasuria dhe mjetet e vena ne dispozicion te Shoqerise nga Ortaku Huaj mund te kthehen ne vendin e origjines.
- Mjetet financiare dhe ato ne natyre, si dhe çdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se Shoqerise, ndahen ndermjet Ortakeve ne perpjestim me pjeset e tyre ne Kapitalin Themeltar, pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjitha detyrimet e shpenzimet e Shoqerise.

NENI 51

Kur pushon veprimtaria e nje Filiali per shkak te saj, afati i mbylljes percaktohet nga Administratoret.
Likuidimi i Filialeve do te behet me te njejten procedure qe parashikohet per pushimin e veprimtarise se Shoqerise.

KAPITULLI IX

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 52

Shoqeria gezon mbrojtjen dhe sigurimin e plote te Ligjit Nr. 7764 date 2.11.1993 "Per Investimet e Huaja", Ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" ne veçanti, si dhe Legjislacionit Shqiptar ne fuqi ne pergjithesi.

NENI 53

Ne rast se ne Republiken e Shqiperise shpallen Ligje, Dekrete e Vendime te cilat synojne nje politike me te favorshme zhvillimi te veprimtarise se Shoqerise nga Legjislacioni ekzistues ne kohen e krijimit te saj, Ortaket kane te drejte t'u drejtohen Organeve Shteterore perkatese qe te aplikohet Legjislacioni me i favorshem.
Ne rast te kundert, d.m.th kur shpallen Ligje, Dekrete e Vendime me karakter jofavorizues per Shoqerine, Shoqeria mbrohet nga garancite qe permenden ne Nenin 46 te ketij Statuti. Nderkaq, Ortaku i Huaj ka te drejten e kerkeses per nderprerjen e funksionimit te veprimtarise se Shoqerise.

NENI 54

Ortaket detyrohen reciprokisht te ruajne sekretin e dokumentacionit te Shoqerise qe ka te beje me informacionin, teknollogjine dhe pervojen e akumuluar prej partnereve apo Shoqerise si dhe te dhenat e ndryshme qe i perkasin asaj. Ata marrin te gjitha masat e duhura per te shmangur publikimin e tyre, qofte edhe pjeserisht.
Ortaket jane pergjegjes per demet qe mund te rrjedhin nga mosrespektimi i ketyre detyrimeve.

NENI 55

Per disiplinimin e jetes organizative dhe veprimtarise ekonomike financiare te Shoqerise, te gjithe personat e punesuar ne te, detyrohen te respektojne dhe te zbatojne detyrimet ligjore, Aktin e Themelimit, Statutin, Rregulloren e Brendeshme te Shoqerise, Statusin e personelit, te drejtat e detyrat qe sanksionohen ne keto dokumenta dhe ne Kontraten

e Punes. Ata jane te detyruar te ruajne sekretin profesional dhe organizativ te Shoqerise.

NENI 56

Mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj Kontrate midis paleve ose mosmarreveshjet qe mund te lindin dhe qe mund te prekin funksionimin dhe mireadministrimin e Shoqerise, Ortaket zotohen se do ti zgjidhin me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, atehere çeshtja do te kaloje ne Gjykaten kompetente nga pala e interesuar, ne perputhje me rregullat proceduriale te parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

NENI 57

Ky Statut hartohet ne 8 (tete) ekzemplare origjinale per t'iu shperndare Organeve kompetente, Paleve Kontraktuese dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

NENI 58

Statuti, pasi u lexua, u gjet i rregullt dhe firmoset pa asnje verejtje nga Ortaket. Statuti hyn ne fuqi siç eshte percaktuar ne paragrafet e meparshem dhe sipas rregullave ne fuqi.

Statuti u perpilua ne Tirane, me 20 Mars 1998 dhe permban 58 (pesedhjetetete) Nene ne 19 (nentembedhjete) faqe. Secili nga Ortaket merr nga nje ekzemplar ne secilen gjuhe.

ORTAKET

Hasan Hafizi

Shpk "K. Geça Konstr." përfaqësuar nga Hasan Hafizi

"Cockerg Bourolin Chaussee" SH.A. përfaqësuar nga Maurice MOISY

Shkëputëra personelisht nga Maurice Moisy

Z. M. Doci
19. 3. 1998

K E R K E S E

PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

KERKUES : 1. **Hasan HAFIZI** i biri i Ramizit i datelindjes 1955 lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane rruga "Sami Frasheri", Pall. 20/1, shk.1, ap. 17 .

2. **Sh.p.k " KARL GEGA KONSTRUKSION "** e ortakeve Hartjan Sallaku, Luan Kopliku, Shkelqim Rakipaj dhe Hasan Hafizi, perfaqesuar me prokure te posacme nga Z. **Hasan HAFIZI.**

3. **Shoqeria Anonime Franceze "COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAL** " perfaqesuar me prokure te posacme nga Z. **Maurice MOISY.**

OBJEKTI Kerkojme rregjistrimin si person juridik te **Sh.p.k me ortakeri, "ALBAVIA"** ne baze te ligjit 7638 dt.19/11/1992 dhe ligjit 7667 dt. 28/01/1993.

Te regjistruar sipas vendimit dt 19-03-98 gjykatave M. Doci

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Ne kerkuesit Hasan HAFIZI, Sh.p.k. " KARL GEGA KONSTRUKSION" e ortakeve Hartjan Sallaku, Luan Kopliku, Shkelqim Rakipaj dhe Hasan Hafizi e Shoqeria anonime "COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAL", me deshiren dhe vullnetin tone te perbashket vendosem te krijojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me ortakeri me emertimin "ALBAVIA", me kapital themeltar 100.000(Njeqindmije) lek , e perbere 25% Z.Hasan HAFIZI, 25% Sh..p.k." KARL GEGA KONSTRUKSION" dhe 50% shoqeria anonime Franceze "COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAL" ,me kohezgjatje te veprimtarise ekonomike mbi 10 vjet , me seli ne qytetin e Tiranes Rruga "Sami Frasheri " Pall. 20/1, shk.1, ap.17, me administratore Z. Hasan HAFIZI , Z. Jean Louis MARCHAND, Z. Maurice MOISY, Z. Valentina KRUJA, me objekt aktivitetit tregtar privat kryesisht ne fushen ndertimore si: konsulenca projektime, ndertime dhe supervizione ne fushen ndertim rrugesh te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj), ndertim pistash e aeroportesh, ndertim veshjesh asfaltike e shtresash rrugore; Punime dherash, sistemime, tarracime terrenesh; Punime te rikonstruksionit, mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijezimit te rrugeve; Ndertime te veprave te artit rrugor e hekurudhor te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, vija dukte, tunele etj); Punime topogjeodezike, gjeollogjike dhe analizash laboratorike per punimet rrugore; Administrim dhe shfrytezim te guroreve, kavove te zhavorrit, karierave te rerave bituminoze, impianteve te betonit, impianteve te perzierjeve bituminoze, impianteve te prodhimit te inerteve etj, perfshire dhe tregtimin e materialeve teknologjike te prodhuar si dhe materialeve te ndertimit, industriale etj; Konsulenca, projektime, ndertime dhe supervizion ne fushat e ndertimeve industriale,

Greffe du Tribunal de Commerce de NANTERRE
4, Rue Pablo Neruda
92020 NANTERRE CEDEX

950 570 960 R.C.S. NANTERRE
Vos références : VT
(1989 B 04675)

Extrait Kbis

IMMATRICULATION AU REGISTRE DU COMMERCE ET DES SOCIETES
Extrait au 27 Février 2007

IDENTIFICATION

Dénomination sociale :	**EUROVIA INTERNATIONAL**
Numéro d'identification :	950 570 960 R.C.S. NANTERRE
Numéro de gestion :	1989 B 04675
Date d'immatriculation :	17 Octobre 1989

RENSEIGNEMENTS RELATIFS A LA PERSONNE

Forme juridique :	société anonyme
Au capital de :	17.176.000,00 Euros
Adresse du siège :	18 Place De L'Europe 92500 Rueil Malmaison
Durée de la société :	Jusqu'au 17 OCTOBRE 2088
Date d'arrêté des comptes :	31 Décembre
Constitution – Dépôt de l'acte constitutif :	Au Greffe du Tribunal de Commerce de NANTERRE le 16 Octobre 1989 sous le numéro 022496
Publication :	La loi du 13 Octobre 1989

ADMINISTRATION

Président directeur général et administrateur	Monsieur JUTIER Patrick *né(e) le* 08/10/1961 à NANTES 44000 *de nationalité* Française *demeurant* 86 Rue Des Gabillons 78290 Croissy Sur Seine
Administrateur	Monsieur MARCHAND JEAN–LOUIS PIERRE JEAN–LOUIS PIERRE *né(e) le* 04/12/1949 à CHATOU 78400 *de nationalité* Française *demeurant* 18 Rue Armand Moisant 75015 Paris
Administrateur	Monsieur DUCOUSSO ALAIN *né(e) le* 10/08/1963 à PALAISEAU 91120 *de nationalité* Française *demeurant* 63 Rue Du 19 Janvier 92380 Garches
Commissaire aux comptes titulaire	CABINET SALUSTRO REYDEL 8 Avenue Delcasse 75008 Paris
Commissaire aux comptes titulaire	DELOITTE & ASSOCIES (572 028 041 R.C.S. NANTERRE) 185 C Avenue Charles De Gaulle 92200 Neuilly Sur Seine *Forme juridique* société anonyme
Commissaire aux comptes suppléant	Monsieur MATHIS PHILIPPE *né(e) le* 08/04/1954 à NANCY 54 *de nationalité* Française

L'ORIGINAL DÉLIVRÉ PAR LE GREFFE DU TRIBUNAL DE COMMERCE EST ÉTABLI SUR PAPIER TRAMÉ

Sekretaria Gjyqesore e Gjykatës Tregtare të Nanterre
4, Rue Pablo Neruda
92020 NANTERRE CEDEX

950 570 960 R.C.S. NANTERRE
Referencat tuaja: VT
(1989 B 04675)

Estrakt Kbis

RREGJISTRIM NE RREGJISTRIN TREGTAR DHE TE SHOQERIVE
Ekstrakt me 27 SHKURT 2007

IDENTIFIKIMI

Emri i shoqërisë :	**EUROVIA INTERNATIONAL**
Numri i identifikimit :	950 570 960 R.C.S. NANTERRE
Numri administrativ :	1989 B 04675
Data e rregjistrimit :	17 Tetor 1989

INFORMACIONE LIDHUR ME PERSONIN :

Forma juridike :	shoqëri anonime
Me kapital :	17. 176. 000,00 Euro
Adresa e selisë:	18, Place de L'Europe 92500 Rueil Malmaison
Kohëzgjatja e shoqërisë :	Deri me 17 TETOR 2088
Data e mbylljes së vitit ushtrimor :	31 Dhjetor
Konstituimi-Depozitimi i aktit konstitues :	Në Sekretarine Gjyqesore të Gjykatës Tregtare të NANTERRES me 16 Tetor në numrin 022496
Publikimi :	Ligji i 13 Tetorit 1989

ADMINISTRIMI

President drejtor i përgjithshëm dhe administrator :	Zoti JUTIER Patrick *Lindur me* 08/10/1961 në NANTES 44000 *Me shtetësi* Franceze *Banor në* 86 Rue Des Gabillons 78290 Croissy Sur Seine
Administrator	Zoti MARCHAND JEAN-LOUIS PIERRE JEAN-LOUIS PIERRE *Lindur me* 04/12/1949 në CHATOU 78400 *Me shtetësi* Franceze *Banor në* 18 Rue Armand Moisant 75015 Paris
Administrator	Zoti DUCOUSSO ALAIN *Lindur me* 10/08/1963 në PALAISEAU 91120 *Me shtetësi* Franceze *Banor në* 63 Rue DU 19 Janvier 92380 Garches
Ekspert kontaběl titullar	CABINET SALUSTRO REYDEL 8 Avenue Delcasse 75008 Paris
Ekspert kontaběl titullar	DELOITTE&ASSOCIES (572 028 041 R.C.S. NANTERRE) 185 C Avenue Charles De Gaulle 92200 Neuilly Sur Seine *Forma juridike* shoqëri anonime
Ekspert kontaběl suplementar	Zoti MATHIS PHILIPPE *Lindur me* 08/04/1954 në NANCY 54 *Me shtetësi* Franceze

experian: 242

ORIGJINALI I NXJERRE NGA SEKRETARIA GJYQESORE E GJYKATES TREGTARE ESHTE NE LETER TE GRAVUAR

Sekretaria Gjyqesore e Gjykatës Tregtare të Nanterre
4, Rue Pablo Neruda
92020 NANTERRE CEDEX

950 570 960 R.C.S. NANTERRE
Referencat tuaja: VT
(1989 B 04675)

Estrakt Kbis

RREGJISTRIM NE RREGJISTRIN TREGTAR DHE TE SHOQERIVE
Ekstrakt me 27 SHKURT 2007

Ekspert kontaboël suplementar

Banor ne 8 Avenue Delcasse 75008 Paris
BEAS
7-9 Villa Houssay 92200 Neuilly Sur Seine

INFORMACIONE LIDHUR ME AKTIVITETIN TREGTAR

Origjina e shoqërisë:	Kjo shoqëri konstituohet
Origjina e fondeve:	Krijimi i një fondi tregtar
Aktiviteti:	Gjithë punimet rrugore publike ose private, shfrytëzim guroresh
Adresa e ndërtesës qëndrore:	18 Place de L'Europe 92500 Rueil Malmaison
Fillimi i aktivitetit me:	12 Tetor 1989
Mënyra e shfrytëzimit:	Shfrytëzim direkt

VEREJTJE

17 Nëntor 2005, numër 42572

Vazhdim i shoqërisë ndonëse një aktiv neto është bërë më i vogël se gjysma e kapitalit social. Asembleja e përgjithshme e 20/10/2004.

NDERTESA JASHTE RESORTIT TE SEKRETARISE GJYQESORE

Sekretaria Gjyqesore e FORT DE FRANCE (TGI)(972I)
Ndërtesa dytësore

Numri administrativ 2000 B 00005

Ekstrakt i nxjerrë në NANTERRE, me 28 Shkurt 2007 në 2 faqe

Sekretari Gjyqesor

Fund i Ekstraktit

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
T I R A N E

Nr 866/3 Rep

V E R T E T I M

Vërtetohet firma e përkthyeses R. Dervishi, banuese në Tiranë e njohur personalisht prej meje, e cila më deklaroi se përkthimi i mësipërm nga shqip në frengjisht është i njejtë me origjinalin dhe nënshkroi para meje sipas ligjit .

Tirane , më 21.03.2007

N O T E R E

REPUBLIQUE D'ALBANIE
OFFICE DE NOTAIRE
T I R A N A

Rep. No 866/3

C E R T I F I C A T E

Je certifie la signature de la traducteur R. Dervishi, residente a Tirana connue par moi personnellement qui a declare que la traduction ci-dessus de l'albanais en français est authentique avec l'original et signe conforme la loi en ma presence.

Tirana , le 21.03.2007

NOTAIRE

N O T E R E
Majlinda E. Demollari
TEL + 355 4 269948

N O T E R E
Majlinda E. Demollari
TEL + 355 4 2269948

ALBAVIA Shpk
Au capital de 65 436 000 Lek, ci-après la « société »
Siège social : Rruge « Pjeter Bogdani » Pall. 39/1, Ap. 5/2 Tirana, Albanie (10055),
immatriculé au registre de Commerce de Tirana N° 19077, en date du 19.03.1998

ASSEMBLEE GENERALE MIXTE DU 22 FEVRIER 2007

RESOLUTIONS

L'An Deux Mille Sept et le 22 février à 9 heures,

Les associés de la Société se sont réunis à Rueil-Malmaison en Assemblée Générale Mixte.

Sont présents :

- EUROVIA INTERNATIONAL, représentée par M Patrick JUTIER 409 parts
- Monsieur Hasan HAFIZI 389 parts

Total : 798 parts

en valeur de 82.000 Lek par part.

Les associés présents ou représentés détiennent ensemble l'intégralité du capital social.

L'Assemblée Générale a été convoquée avec l'ordre du jour suivant :

Partie Ordinaire :

1. Renouvellement du mandat des Administrateurs de la Société pour une période de 3 ans

Partie Extraordinaire :

2. Transfert du siège d'ALBAVIA
3. Modification corrélative des statuts
4. Questions diverses.

Après discussion, les associés approuvent à l'unanimité les résolutions suivantes :

PARTIE ORDINAIRE

PREMIERE RESOLUTION

Les mandats des administrateurs venant à échéance en 2007, les Associés décident de renouveler les mandats d'administrateur de :

- Monsieur Jean-Louis MARCHAND,
- Monsieur Hasan HAFIZI,
- Monsieur Philippe PEYTAVIN,
- Monsieur Daniel ROFFET,

Pour une durée de 3 ans venant à échéance en 2010.

Cette résolution mise aux voix est adoptée à l'unanimité

PARTIE EXTRAORDINAIRE

DEUXIEME RESOLUTION

Les Associés approuvent le changement du siège social de la société. Le nouveau siège social de la société se situe à l'adresse suivante : Rruga Sulejman Delvina, Ap. 19, Tirane, ALBANIE

Cette résolution mise aux voix est adoptée à l'unanimité

TROISIEME RESOLUTION

En conséquence de la première résolution, les Associés décident de modifier comme suit l'article 4 alinéa 1 de ses statuts :

« La Société ALBAVIA SRL a son siège social à Tirana, République d'Albanie, à l'adresse Rruga Sulejman Delvina, Ap. 19, Tirane »

Cette résolution mise aux voix est adoptée à l'unanimité

QUATRIEME RESOLUTION

Les Associés confèrent tous pouvoirs à Monsieur Hasan HAFIZI pour effectuer, directement ou par délégation, les formalités afférentes à la présente Assemblée.

Cette résolution mise aux voix est adoptée à l'unanimité

Plus rien n'étant à l'ordre du jour, la séance est levée.

De tout ce qui précède, il a été dressé le présent procès-verbal qui, après lecture faite, a été signé par les associés.

EUROVIA INTERNATIONAL
Patrick JUTIER

Vu pour certification matérielle de la signature de P. Jutier apposée ci-contre

Monsieur Hasan HAFIZI

Albavia Shpk
Me kapital prej 65 436 000 Lek, më poshtë "shoqëria"
Selia qëndrore: Rruga "Pjetër Bogdani" Pall. 39/1, Ap. 5/2 Tirana, Shqipëri (10055),
e rregjistruar në rregjistrin Tregtar të Tiranës N^0 19077, datë 19.03.1998

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME MIKSE E 22 SHKURTIT 2007

VENDIME

Në Vitin Dy Mijë e Shtatë, me 22 Shkurt në orën 9,

Ortakët e Shoqërisë janë mbledhur në Rueil-Malmaison në Asamble të Përgjithshme Mikse.

Janë të pranishëm:

- EUROVIA INTERNATIONAL, përfaqësuar nga Z. Patrick JUTIER 409 pjesë
- Z. Hasan HAFIZI 389 pjesë

Totali 798 pjesë
Me vlerë 82.000 Lek pjesa

Ortakët e pranishëm ose të përfaqësuar kanë bashkërisht të gjithë kapitalin e shoqërisë.

Asambleja është thirrur me rendin e ditës si më poshtë :

Pjesa e zakonshme :

1. Rinovimi i mandatit të Administratorëve të Shoqërisë për një periudhë prej 3 vitesh.

Pjesa e jashtëzakonshme :

2. Transferimi selisë së ALBAVIA-s
3. Modifikimi përkatës i statuteve
4. Çështje të ndryshme

Pas diskutimeve, ortakët aprovojnë me unanimitet vendimet që vijojnë :

PJESA E ZAKONSHME

VENDIMI I PARE

Meqë mandatet e administratorëve mbarojnë në 2007, Ortakët vendosin të rinovojnë mandatet e administratorit për :

- Zotin Jean-Louis MARCHAND,
- Zotin Hasan HAFIZI,
- Zotin Philippe PEYTAVIN,
- Zotin Daniel ROFFET,

Për një periudhë të 3 viteve pasuese me përfundim në 2010.

Ky vendim i vënë në votë është aprovuar unanimisht.

PJESA E JASHTEZAKONSHME

VENDIMI I DYTE

Ortakët miratojnë ndryshimin e selisë qëndrore të shoqërisë. Selia e re qëndrore e shoqërisë ndodhet në adresën : Rruga Sulejman Delvina, Ap. 19, Tiranë, SHQIPERI ;

Ky vendim i vënë në votë është aprovuar unanimisht.

VENDIMI I TRETE

Si rrjedhim i vendimit të parë, Ortakët vendosin të modifikojnë si në vijim nenin 4 fraksion 1 të statutit :

« Shoqëria ALBAVIA Shpk e ka selinë qëndrore në Tiranë, Republika e Shqipërisë, në adresën Rruga Sulejman Delvina, Ap. 19, Tiranë. »

Ky vendim i vënë në votë është aprovuar unanimisht.

VENDIMI I KATERT

Ortakët i japin të gjitha fuqitë Zotit Hasan HAFIZI për të kryer, drejtpërdrejtë apo me delegim, vendimet e kësaj Asambleje.

Ky vendim i vënë në votë është aprovuar unanimisht.

Pas përfundimit të rendit të ditës, seanca mbyllet.

Për gjithë çka më sipër, është hartuar ky proces-verbal që, pasi u lexua, u firmos nga ortakët.

EUROVIA INTERNATIONAL
Patrick JUTIER

Zoti Hasan HAFIZI

APOSTILLE
(Konventa e Hages e 5 Tetorit 1961)

1. Republika Franceze

Ky akt publik :

2. eshte firmosur nga **Z. THABEAULT**
3. ne cilesine e **Noterit**
4. eshte vulosur/vene pulla nga **studio e tij**

U atestua

5. ne **Paris**
6. me **13 Mars 2007**
7. Nga Prokurori i Pergjithshem Prane Gjykates se Apelit **Paris**
8. me nr. **22593**
9. **Vula**

Gjykata e Apelit Paris Znj.TEPLIER 10. **Firma**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
T I R A N E

Nr 864/1 Rep

V E R T E T I M

Vërtetohet firma e përkthyeses R. Dervishi, banuese në Tiranë e njohur personalisht prej meje, e cila më deklaroi se përkthimi i mësipërm nga shqip në frengjisht është i njejtë me origjinalin dhe nënshkroi para meje sipas ligjit .

Tirane , më 21.03.2007

N O T E R E

REPUBLIQUE D'ALBANIE
OFFICE DE NOTAIRE
T I R A N A

Rep. No 864/1

C E R T I F I C A T E

Je certifie la signature de la traducteur R. Dervishi, residente a Tirana connue par moi personnellement qui a declare que la traduction ci-dessus de l'albanais en français est authentique avec l'original et signe conforme la loi en ma presence.

Tirana , le 21.03.2007

NOTAIRE

N O T E R E
Mylënda E. Dervishi
TEL + 355 4 266941

N O T E R E
Mylënda E. Dervishi
TEL + 355 4 266941

/7

2 MAR. 2007

KERKESE

KERKUESI: Shoqeria "Albavia" sh.p.k, e regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin nr 19077, date 19.03.1998 dhe perfaqesuar nga Administratori Z. Hasan Hafizi, me adrese Rr. "Pjeter Bogdani", pall 39/1,Apt 5/2, Tirane

3. Approbation du rapport du Commissaire aux Comptes de la société sur l'activité financière de l'exercice 2002,
4. Nomination du Commissaire aux Comptes pour les exercices de 2003 et 2004 et approbation de sa rémunération,
5. Approbation du plan des investissements pour l'année 2003
6. Approbation des pouvoirs de l'Administrateur Délégué
7. Approbation de la démission de Monsieur Didier Chapatte de ses fonctions d'Administrateur de la société.
8. Divers

et voter en mes lieu et place sur toute décision prise par ladite Assemblée, signer tous procès-verbaux et pièces et, en général, faire le nécessaire.

Fait à Rueil-Malmaison,
Le 22 mai 2003

Bon pour pouvoir

Jean-Claude TEXIER

Siège social :
18, Place de l'Europe
92565 Rueil-Malmaison Cedex
Tél. : 01 47 16 38 00
Fax : 01 47 16 38 01
S.A. au capital de 17 176 000 €
950 570 960 RCS Nanterre

Une société de VINCI

ALBAVIA sh.p.k
Me kapital themeltar prej 48.134.000 Lek, me poshte "Shoqeria"
Selia: Rruga « Pjeter Bogdani », Pall.31/1, Ap.5/2, Tirana, Albanie (10055) Regjistruar ne Regjistrin Tregtar me Vendim Nr. 19077, date 19.03.1998

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme date 23 Maj 2003

VENDIME

Ne Vitin Dy mije e tre, data 23 Maj, ora 11.

Eshte mbledhur Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme e Ortakeve te Shoqerise ALBAVIA Shpk. ne Seline e Shoqerise Eurovia International. ne RUEIL-MALMAISON (92565) – France- 18 Place de l'Europe.

Jane te pranishem Ortaket:

- Eurovia International, i perfaqesuar nga Z. Daniel ROFFET 409 pjese
- Zoti Hasan Hafizi 178 pjese

Totali : 587 pjese

Me vlere prej 82.000 Lek per pjese.

Ortaket e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne se bashku te gjithe kapitalin themeltar te Shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme e Ortakeve eshte mbajtur duke ndjekur rendin e dites si me poshte :

1. Miratimi i raportit te administratoreve mbi aktivitetin ekonomik dhe financiar te ALBAVIA-s ne 2002 dhe perspektivat per vitin 2003.
2. Miratimi i bilancit ekonomik dhe financiar te vitit ushtrimor 2002.
3. Miratimi i raportit te Ekspertit Kontabel te shoqerise mbi aktivitetin financiar te ushtrimit 2002.
4. Emerimi i Ekspertit Kontabel per vitin 2003 dhe 2004 dhe miratimi i pageses se tij.
5. Miratimi i planit te investimeve per vitin 2003.
6. Miratimi i Autorizimit te Administratorit te Deleguar.
7. Miratimi i doreheques se z. Didier Chapatte nga funksionet e Administratorit te shoqerise.
8. Te ndryshme.

Pas diskutimesh, Ortaket miratojne ne unanimitet vendimet e meposhtme :

VENDIMI I PARE

Ortaket miratojne raportin e administratoreve mbi aktivitetin ekonomik dhe financiar per vitin 2002 te shoqerise dhe perspektivat e vitit 2003.

VENDIMI I DYTE

Ortaket miratojne bilancin ekonomik dhe financiar te vitit 2002 qe nxjerr ne dukje nje humbje prej 9 200 600 Leke, para tatimit.

VENDIMI I TRETE

Ortaket miratojne raportin e Ekspertit Kontabel te shoqerise, Gjin Consulting ltd., mbi aktivitetin financiar te vitit 2002.

VENDIMI I KATERT

Ortaket miratojne emerimin e Gjin Consulting ltd. ne cilesine e Ekspertit Kontabel te shoqerise per vitet 2003 dhe 2004 si dhe pagesen e tij ne shumen 3.560 USD per vitin 2003 dhe 3.560 USD per vitin 2004.

VENDIMI I PESTE

Ortaket miratojne planin e investimeve per vitin 2003 qe rritet ne 21 500 000 Leke duke i dhene mundesine Komitetit Drejtues te atribuoje nje shume plotesuese, nese e gjykon te nevojshme.

VENDIMI I GJASHTE

Ortaket miratojne me ndryshimet e meposhtme kompetencat e dhena Z. Hasan Hafizi ne cilesine e Administratorit te Deleguar te Shoqerise me Autorizimin e dates 31 dhjetor 1999, i ndryshuar me Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te dates 29 qershor 2000:

- Shuma prej 100 000 000 lekesh e permendur ne paragrafin 4.1 dhe e ndryshuar ne 200 000 000 Lek nga Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme me 29/06/2000 eshte rritur tani ne 300 000 000 Lek.
- Shuma prej 100 000 000 lekesh e permendur ne paragrafin 4.2 dhe e ndryshuar ne 200 000 000 lek nga Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme e 29/06/2000 eshte rritur tani ne 300 000 000 Lek.
- Nje Autorizim i ri do te redaktohet per kete efekt dhe do te zevendesoje Autorizimin aktual te dates 31/12/1999.
- Klauzolat e tjera mbeten te pandryshuara.

VENDIMI I SHTATE

Ortaket miratojne unanimisht doreheqjen e Z. Didier Chapatte nga funksionet e tij si Administrator i shoqerise, qe hyn ne fuqi nga kjo dite, per shkak te emerimit te tij ne nje funksion tjeter.

Per rrjedhoje, Administratoret e shoqerise duke filluar nga sot jane si me poshte :

- Z. Jean-Louis MARCHAND, i emeruar me vendimin e Asamblese se Pergjithshme te dates 19 mars 1998.
- Z. Hasan HAFIZI, i emeruar me vendimin e Asamblese se Pergjithshme te dates 19 mars 1998.
- Z. Philippe PEYTAVIN, i emeruar me vendimin e Asamblese se Pergjithshme te dates 9 shtator 1999.
- Z. Daniel ROFFET, i emeruar me vendimin e Asamblese se Pergjithshme te dates 12 qershor 2001.

Ortaket verejne qe ne perputhje me nenin 39 te statutit te shoqerise, mandatet e zoterinjve Marchand, Peytavin dhe Hafizi jane rinovuar ne menyre te heshtur, per nje periudhe tre vjecare, qe nga asambleja e pergjithshme e dates 12 qershor 2001 gjate se ciles Ortaket kishin marre vendim lidhur me Administratoret e shoqerise per periudhen ne vazhdim. Qe nga ai cast, Ortaket konstatojne se nuk ka vend per te rinovuar mandatet e Administratoreve para vitit 2004.

VENDIMI I TETE

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme autorizon Z. Hafizi per te kryer, personalisht ose nepermjet personave te trete qe ai mund te caktoje, te gjitha veprimet e nevojshme per depozitimin e vendimeve te Asamblese ne perputhje me legjisilacionin shqiptar si dhe te gjitha formalitetet e nevojshme qe kane te bejne me Asamblene ne fjale.

Meqe nuk ka asgje tjeter ne rendin e dites, Mbledhja mbyllet.

Sa me siper, u mbajt procesverbali ne fjale qe, pasi u lexua, u nenshkrua nga Ortaket.

EUROVIA INTERNATIONAL

Daniel ROFFET
(nenshkrimi)

Zoti Hasan HAFIZI

(nenshkrimi)

NOTERI
(nenshkrimi)

EUROVIA INTERNATIONAL

P R O K U R E

Unc. i nenshkruari **Jean-Claude Texier**,

me adrese: CHEVREUSE (78460) – 8. Port Roual. France

Ne cilesine e Presidentit. Drejtor i Pergjithshem i shoqerise "EUROVIA INTERNATIONAL" Sh.a me kapital 17 176 000 EURO. dhe me seli qendrore ne "Place d'Europe 92565 Rueil Malmaison –18", e regjistruar me nr 950 570 960 RCS NANTERRE,

Zoteruese e 409 pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise "Albavia"

Nepermjet ketij Akti autorizoj **Z. Daniel Roffet** qe te perfaqesoje shoqerine "EUROVIA INTERNATIONAL" Sh.a ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve te shoqerise "ALBAVIA" Shpk. qe do te mbahet ne

Te premten 23 Maj 2003, ora 11.00,
ne adresen: "Place d'Europe 92565 Rueil Malmaison –18" France.

lidhur me pikat e rendit te dites si me poshte:

1. Miratimi i raportit te administratoreve mbi aktivitetin ekonomik dhe financiar te shoqerise ALBAVIA ne vitin 2002 dhe perspektivat per vitin 2003.
2. Miratimi i bilancit ekonomik dhe financiar te vitit ushtrimor 2002.
3. Miratimi i raportit te Ekspertit Kontabel te shoqerise mbi aktivitetin financiar te vitit 2002.
4. Emerimi i Ekspertit Kontabel per vitin 2003 dhe 2004 dhe miratimi i pageses se tij.
5. Miratimi i planit te investimeve per vitin 2003.
6. Miratimi i Autorizimit te Administratorit te Deleguar.
7. Miratimi i doreheqjes se Z. Didier Chapatte nga funksionet e Administratorit te shoqerise.
8. Te ndryshme.

Perfaqesuesi autorizohet te marre pjese ne kete asamble, dhe ne te gjitha asamblete vijuese qe do te vendosin me vone mbi te njejtin rend dite, te nenshkruaje te gjithe fleteprezencat, te marre pjese ne te gjitha vendimet dhe votimet per ceshtjet e rendit te dites. Per sa me siper, te firmose te gjithe procesverbalet, dhe te kryeje te gjithe veprimet e nevojshme.

Hartuar ne Rueil Malmaison
22 Maj 2003

Jean-Claude Texier
Firma

Perkthen:

Oltiana Dishnica

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 6461 Rep. Tirane, me 5.06.2003

VERTETIM

Me ane te te cilit vertetohet firma e perkthyeses Oltina Dishnica, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje, e cila u paraqit duke me deklaruar se e ka perkthyer dokumentin bashkengjitur ne perputhje me origjinalin nga frengjishtja ne shqip dhe firmosi rregullisht ne pranine time.

NOTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE
A. GJIM XH. ROBO
NOTER
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
A. GJIM XH. ROBO
NOTER
TIRANE
PULE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

KERKESE

Kerkuesi: Shoqeria "ALBAVIA" Shpk. e perfaqesuar nga Administratori Z. Hasan Hafizi.

Objekti: Regjistrimi i ndryshimeve ne kollonat perkatese te Regjistrit Tregtar dhe depozitimi ne aneksin e tij, te Vendimeve te Asamblese se Ortakeve te shoqerise date 23.05.2003 dhe te dokumenteve te tjere perkates.

Baza Ligjore: Ligji nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE, TIRANE

Shoqeria "ALBAVIA" Shpk. eshte regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr. 19077, date 19.03.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane.

Me date 23.05.2003 Asambleja e Ortakeve te shoqerise "ALBAVIA" Shpk. ka vendosur:

1. Te miratoje marrjen nga ana e shoqerise ALBAVIA Shpk. te kredive bankare, huave dhe linjave te llogarive bankare te zbuluara, etj. te leshuara nga "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA" pa kufizim persa i perket datave te shlyerjeve, si dhe miratimin e te gjitha transaksioneve bankare te lidhura me kredite, huate etj. qe shoqeria ALBAVIA SHpk. do te realizoje nepermjet kesaj banke, brenda kufijve maksimale te pershkruar me poshte:
   - Linje llogarie bankare te zbuluar prej 300.000 (treqind mije) USD.
   - Hua afatgjate/shkurter prej 400.000 (katerqind mije) USD per financimin e investimeve te ardhshme te Shoqerise.

Miratimin e nenshkrimit nga shoqeria ALBAVIA Shpk. te garancive dhe te marreveshjeve siguruese ne favor te "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA" ne kufijte maksimale te percaktuar ketu me poshte, persa i takon:
   - Sigurimit nepermjet kontratave qe shoqeria ALBAVIA Shpk. ka ne proces zbatimi;
   - Sigurimit nepermjet te gjitha aktiveve ne pronesi te shoqerise ne momentin e nenshkrimit te marreveshjeve te siperpermendura me "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA".

2. Autorizohet Zoti Hasan HAFIZI, lindur me 11 Shkurt 1955 ne Lezhe, mbajtes i pasaportes nr.012688, Administrator i Shoqerise ALBAVIA Shpk., te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise me qellim ekzekutimin e vendimit te siperpermendur. Per kete qellim, Z. Hafizi, duke vepruar vetem ose nepermjet personave te trete qe ai mund te caktoje, eshte i autorizuar:

   - Te kerkoje kredi bankare, hua e linja llogarish bankare te zbuluara, etj., dhe te negocioje kushtet kontraktuale te ketyre kredive, etj.
   - Te nenshkruaje te gjitha aktet ndermjet "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA" dhe Shoqerise ALBAVIA Shpk. lidhur me kredite bankare, huate dhe linjat e llogarive bankare te zbuluara etj., brenda kushteve te percaktuara ketu me siper,
   - Te nenshkruaje garanci dhe marreveshje siguruese, brenda kufijve maksimale te percaktuar ketu me siper, duke perfshire marreveshje pengu, hipoteke, barre siguruese si dhe te gjitha marreveshjet lidhur me cedimin e te drejtave qe rrjedhin nga kontratat qe shoqeria ka nenshkruar me te trete,

- Te perdore fondet e kredive, te hape nje ose me shume llogari bankare tek "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA", te kryeje transferta bankare me keto llogari si dhe çdo lloj transaksioni tjeter prane "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA",
- Te nenshkruaje çdo lloj akti tjeter dhe te marre masat e nevojshme ose te kryeje formalitetet e kerkuara per te ekzekutuar angazhimet e marra nga Shoqeria AlBAVIA Shpk. kundrejt "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA".

Ky Autorizim ka efekt deri ne daten 31 dhjetor 2003. Ne rast se perpara perfundimit te ketij afati, Asambleja e Ortakeve te Shoqerise vendos te revokoje kete Autorizim ose nese Z. Hafizi deklaron se nuk pranon me kompetencat e dhena me siper, Shoqeria ALBAVIA Shpk. do te njoftoje per kete menjehere me shkrim "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA". Revokimi i autorizimit ka efekt kundrejt "COMMERCIAL BANK OF GREECE ALBANIA" te nesermen e dates se marrjes se ketij njoftimi.

3. Miratimin me ndryshimet e meposhtme te kompetencave te dhena Z. Hasan Hafizi ne cilesine e Administratorit te Deleguar te Shoqerise me Autorizimin e dates 31 dhjetor 1999, ndryshuar me Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te dates 29 qershor 2000:

- Shuma prej 100.000.000 Leke e permendur ne paragrafin 4.1 te Autorizimit, e ndryshuar ne 200.000.000 Leke nga Asambleja e Ortakeve e dates 29.06.2000, rritet ne shumen 300.000.000 Leke (treqind milion).
- Shuma prej 100.000.000 Leke e permendur ne paragrafin 4.2 te Autorizimit, e ndryshuar ne 200.000.000 Leke nga Asambleja e Ortakeve e dates 29.06.2000, rritet ne shumen 300.000.000 Leke (treqind milion).
- Nje Autorizim i ri i cili do te hartohet per te reflektuar ndryshimet e siperpermendura, do te zevendesoje Autorizimin aktual te dates 31/12/1999.
- Klauzolat e tjera te Autorizimit mbeten te pandryshuara.

4. Miratimin e doreheqjes se Z. Didier Chapatte nga funksionet e tij si Administrator i shoqerise, me efekt nga data 23.05.2003 per shkak te emerimit te tij ne nje funksion tjeter.

Pas ketij vendimi, Administratoret e shoqerise ALBAVIA Shpk. jane si me poshte:

- Z. Jean-Louis Marchand, i emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve 19.03.1998.
- Z. Hasan Hafizi, i emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve 19.03.1998.
- Z. Philippe Peytavin, i emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve 09.09.1999.
- Z. Daniel ROFFET, i emeruar me vendimin e Asamblese se Ortakeve 12.06.2001.

Ortaket verejne qe ne perputhje me nenin 39 te statutit te shoqerise, mandatet e zoterinjve Marchand, Peytavin dhe Hafizi jane rinovuar heshturazi, per nje periudhe tre-vjecare, me vendimin e Asamblese se Ortakeve te dates 12.06.2001, ne te cilen ishte vendosur lidhur me Administratoret e shoqerise per periudhen ne vazhdim. Qe nga ai moment, Ortaket konstatojne se nuk ka vend per te rinovuar mandatet e Administratoreve para vitit 2004.

5. Autorizohet Z. Hafizi qe te kryeje, personalisht ose nepermjet personave te tjere qe ai mund te caktoje, te gjitha veprimet e nevojshme per depozitimin e vendimeve te Asamblese ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe te gjitha formalitetet e nevojshme qe kane te bejne me Asamblete ne fjale.

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", i drejtohemi Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane me kerkesen per regjistrimin e ndryshimit ne kollonen perkatese te regjistrit tregtar dhe depozitimin ne aneksin e tij te Vendimeve te Asamblese se Ortakeve te shoqerise, date 23.05.2003.

Administrator

Hasan Hafizi

NOTER TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 9163 **Rep.**
Nr. — **Kol.**

V E R T E T I M

Ne Tirane, sot me 24.07.2003, perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Z. Hasan Hafizi, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhe, me 11.02.1955, mbajtes i pasaportes nr. 0012688, banues ne Tirane person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti identifikues qe me paraqiti.

Pasi une noteri, ia lexova dhe shpjegova aktin bashkangjitur ketij vertetimi, ai me deklaroi se e kupton, e pranon dhe se e ka hartuar ate ne perputhje me vullnetin e tij te plote e te lire, dhe e nenshkruan rregullisht ne pranine time, gje te cilen une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTER

Xh. Robo

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM Xh. ROBO NOTER TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM Xh. ROBO NOTER TIRANË 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

ALBAVIA

Rruge "Sami Frasheri" - Pall 20/1 Shkalla e Pare Ap 17 TIRANA ALBANIE

P O U V O I R

Je Soussigné, **Roger MARTIN**

agissant en qualité de Président Directeur Général
de la Société **EUROVIA INTERNATIONAL**

Société Anonyme
au capital de 17 176 000 Euros,
dont le siège social se trouve 18, Place de l'Europe 92565 RUEIL MALMAISON
immatriculée au RCS de NANTERRE sous le numéro 950 570 960

Propriétaire de 1 129 995 actions d'ALBAVIA,

Donne par les présentes pouvoir à **Daniel ROFFET**,

à l'effet de représenter la Société à l'assemblée générale des actionnaires de la ALBAVIA convoquée le 12 juin 2001 à 10 heures, à Rueil Malmaison.

En conséquence :

- Assister à cette assemblée et à toutes les assemblées subséquentes délibérant sur le même ordre du jour au cas où le quorum ne serait pas atteint lors de la ou des précédentes réunions,
- Emarger toute feuille de présence,
- Accepter les fonctions de scrutateur ou de secrétaire à l'assemblée,
- Prendre part à toute délibération et à tout vote sur les questions à l'ordre du jour,

Aux effets ci-dessus, signer tous procès-verbaux, toutes pièces et, en général, faire le nécessaire.

Fait à Rueil Malmaison
le 12 6 2001

Bon pour pouvoir
(signature sous la mention manuscrite "Bon pour pouvoir")

REPUBLIKA SHQIPERISE
AGIM XH. ROBO
NOTER TIRANE

REPUBLIKA SHQIPERISE
ZYRA E NOTEREVE TIRANE
Nr 3548 Rep
Dt 7/4/03
VERTETIM
Vërtetohet se kopja është e njëjtë me origjinalin Dokumenti
U Paraqit
Pasap
NOTER AGIM ROBO

TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

ALBAVIA
Rruga" Sami Frasheri" P 20/1, Sh 1, Ap 17, Tirane

PROKURE

Unë, i nenshkruari Roger MARTIN,

Ne cilesine e Presidentit, Drejtor i Pergjithshem i shoqerise "EUROVIA INTERNATIONAL" Sh.a me kapital 17 176 000 EUR, dhe me seli qendrore ne "Place d'Europe 92565 Rueil Malmaison –18", e regjistruar me nr 950 570 960 RCS NANTERRE,

Zoterues i 1.129.995 aksioneve te shoqerise "Albavia"

Nepermjet ketij Akti autorizoj Z. **Daniel Roffet** qe perfaqesoje shoqerine "EUROVIA INTERNATIONAL" Sh.a ne Asamblene e Pergjitheshme te Ortakeve te shoqerise "ALBAVIA" Shpk. qe do te mbahet ne 12 Qershor 2001, ora 10.

Per pasoje, personi i siperpermendur autorizohet:

Te marre pjese ne kete asamble, dhe ne te gjitha asamblete vijuese qe do te vendosin me vone mbi te njejtin rend dite, ne rastet kur kuorumi nuk do te arrihet ne mbledhjet e meparshme.

Te nenshkruaje te gjithe fleteprezencat.

Te pranoje funksionin e vezhguesit, ose te sekretarit te asamblese.

Te marre pjese ne te gjitha vendimet dhe votimet per ceshtjet e rendit te dites,

Per sa me siper, te firmose te gjithe procesverbalet, dhe te kryeje te gjithe veprimet e nevojshme.

Hartuar ne Rueil Malmaison
12 Qershor 2001

Roger Martin
Firma

Perkthyes:

Ajdia Jolui

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 3548 Rep. Tirane, me 7.04.2003

VERTETIM

Me ane te te cilit vertetohet firma e perkthyeses Arjola Spahiu, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje, e cila u paraqit duke me deklaruar se e ka perkthyer dokumentin bashkengjitur ne perputhje me origjinalin nga frengjishtja ne shqip dhe firmosi rregullisht ne pranine time.

N O T E R

Agim Robo

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM XH. ROBO NOTER TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM XH. ROBO NOTER TIRANE

PUNE TARGET

100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DECISION

DE L'ASSEMBLEE DE LA SOCIETE "ALBAVIA SRL

Aujourd'hui le 12.06.2001, au siège social de la société EUROVIA INTERNATIONAL S.A. 18 à Rueil Malmaison, 18 Place de l'Europe, s'est réunie l'Assemblée des partenaires de la Société Albavia.

Dans la réunion étaient présents tous les partenaires de la société:

- Le Partenaire EUROVIA INTERNATIONAL, qui possède 409 parts du capital de la société, représenté par M Daniel ROFFET muni de pouvoir;

- Le Partenaire M Hasan HAFIZI, qui possède 178 parts du capital de la société.

L'Assemblée a examiné les questions suivant l'ordre du jour:

1. L'approbation du Rapport de l'Administrateur Délégué sur l'activité économique et financière de la société Albavia pour l'année 2000.

2. L'approbation Bilan économique et financier de l'Administrateur Délégué de la société pour l'année d'exercice 2000.

3. L'approbation du rapport du Commissaire aux Comptes sur le bilan de la société pour l'année d'exercice 2000.

4. L'approbation du plan des investissements pour l'année 2001.

5. L'approbation de la démission de l'Administrateur M Luc BODSON et son remplacement par M Daniel ROFFET.

6. L'approbation de la proposition de EUROVIA pour ajouter un autre Administrateur à la société M Didier CAPATTE.

7. Divers.

Après les discussions les Partenaires ont décidé unanimement de:

1. Approuver le Rapport sur l'activité économique et financière de la société Albavia pour l'année 2000.

2. Approuver le Bilan économique et financier de l'Administrateur Délégué de la société pour l'année d'exercice 2000.

   Le profit de la société avant impôt est : 866,509 Leks.

Du profit brut susmentionné, l'on déduit le montant de 2,475,000 Leks destiné à une provision sur l'impôt sur le revenu.
Après la déduction de la provision sur l'impôt sur le revenu, la société résulte avec une perte de : - 1,608,188 qui va au compte "Pertes de l'année d'exercice".

3. Approuver le rapport du Commissaire aux Comptes sur le bilan de la société pour l'année d'exercice 2000.

4. Approuver le plan des investissements pour l'année 2001 comme suit:

   - Balance pour véhicules de 150,000 FF
   - Laboratoire de 80,000 FF

5. Approuver la démission de M Luc BODSON et son remplacement par M Daniel ROFFET comme Administrateur de la société.

8. Approuver l'approbation de la proposition de EUROVIA pour l'augmentation du nombre des administateurs et de coopter M Didier CHAPATTE comme Administrateur de la société.

Avec ces changements, les administrateurs de la société sont comme suit:

- M Jean-Louis MARCHAND
- M Daniel ROFFET
- M Philippe PEYTAVIN
- M Didier CHAPATTE
- M Hasan HAFIZI

N'ayant pas d'autres sujets à examiner, la réunion de l'Assemblée des Partenaires de la société Albavia est terminée.

LES PARTENAIRES

EUROVIA INTERNATIONAL

DANIEL ROFFET

M Hasan HAFIZI

VENDIM

I ASAMBLESE SE SHOQERISE ALBAVIA SHPK

Sot më datë 12.06.2001, në selinë e shoqërisë EUROVIA INTERNATIONAL S.A., në Rueil Malmaison, 18 Place de l'Europe, u mblodh Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë ALBAVIA shpk.

Në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë:

- Ortaku Eurovia International, zotëruesi i 409 kuotave të kapitalit të shoqërisë, i përfaqësuar nga Z Daniel ROFFET i autorizuar me prokurë,

- Ortaku, Z Hasan HAFIZI, zotërues i 178 kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Asambleja mori në shqyrtim çështjet sipas rendit të ditës si më poshtë:

1. Miratimi i Raportit të Administatorit të Deleguar mbi aktivitetin ekonomiko-financiar të shoqërisë Albavia për vitin 2000.

2. Miratimi i Bilancit ekonomiko-financiar të shoqërisë për vitin financiar 2000.

3. Miratimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar mbi bilancin e shoqërisë për vitin financiar 2000.

4. Miratimi i pasqyrës së investimeve për vitin financiar 2001.

5. Miratimi i dorëheqjes së Administartoreit Z Luc BODSON dhe zëvendësimi i tij me Z Daniel ROFFET.

6. Miratimi i propozimit të Eurovia International për t'i shtuar shoqërisë edhe një Administrator tjetër Z. Didier CHAPATTE.

7. Të ndryshme.

Pas diskutimit të Ortakët vendosën unanimisht:

1. Miratimin e Raportit mbi aktivitetin ekonomiko-financiartë shoqërisë Albavia për vitin 2000.

2. Miratimin e Bilancit ekonomiko-financiar të shoqërisë për vitin financiar 2000.

Fitimi i shoqërisë para tatimit është 866,509 Leke.
Nga fitimi bruto i sipërpërmendur zbritet shuma 2,475,000 Leke e destinuar si provizion për tatimin mbi fitimin.
Pas zbritjes së provizionit për tatimin mbi fitimin, shoqëria rezulton me humbje - 1,608,188 që shkon në llogarinë "Humbje të vitit ushtimor".

3. Miratimin e Raportit të Ekspërtit Kontabël të Autorizuar mbi bilancin e shoqërisë për vitin financiar 2000.

4. Miratimi i planit të investimeve për vitin 2001 si më poshtë:

   - Peshore automjetesh për 150,000 FF
   - Pajisje laboratorike për 80,000 FF

5. Miratimin e dorëheqjes së Z Luc BODSON dhe zëvendësimin e tij me Z Daniel ROFFET.si Administrator i shoqërisë.

6. Miratimin e propozimit të Eurovia International për t'i shtuar shoqërisë edhe një Administrator tjetër, dhe si pasoje kooptimin e Z. Didier CHAPATTE si Administrator të shoqërisë.

Me këto ndryshime, Administratorët e shoqërisë Albavia shpk janë si më poshtë:

- Z Jean Louis MARCHAND
- Z Daniel ROFFET
- Z Philippe PEYTAVIN
- Z Didier CHAPATTE
- Z Hasan HAFIZI

Duke mos patur çështje tjetër për të shqyrtuar, mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë Albavia u mbyll.

ORTAKËT

EUROVIA INTERNATIONAL

DANIEL ROFFET

Z. HASAN HAFIZI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 3544 **Rep.**
Nr. — **Kol.**

VERTETIM

Ne Tirane, sot me 07.04.2003, perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Z. Hasan Hafizi, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhe, me 11.02.1955, mbajtes i pasaportes nr. 0012688, banues ne Tirane dhe Z. Daniel Roffet, shtetasd francez, lindur me 21.11.1951, ne Pithivierrs (45), France, mbajtes i pasaportes nr. 01 ZA 67005, persona madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat identifikues qe me paraqiten.

Pasi une noteri, ua lexova dhe shpjegova aktin bashkangjitur ketij vertetimi, ata ne pranine e perkthyeses Znj. Arjola Spahiu, me deklaruan, se e kuptojne, e pranojne dhe se e kane hartuar ate ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, dhe e kane nenshkruar ate rregullisht jashte kesaj zyre. Une Noteri e vertetoj kete deklarim sipas ligjit.

NOTER

100 LEKE
RSHQIPERISE

19077/3

09.04.2003

KERKESE

(13)

Kerkuesi: Shoqeria "ALBAVIA" Shpk. e perfaqesuar nga Administratori Z. Hasan Hafizi.

Objekti: Regjistrimi i ndryshimeve ne kollonat perkatese te Regjistrit Tregtar dhe depozitimi ne aneksin e tij, te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise, date 12.06.2001 dhe te dokumenteve te tjere perkates.

Baza Ligjore: Ligji nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE, TIRANE

Shoqeria "ALBAVIA" Shpk. eshte regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar, me vendimin nr. 19077, date 19.03.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane.

Me date 12.06.2001 Asambleja e Ortakeve te shoqerise "ALBAVIA" Shpk. ka vendosur:

1. Miratimin e doreheqjes se Administratorit Z. Luc BODSON dhe zevendesimin e tij me Z. Daniel ROFFET.
2. Emerimi i Z. Didier CHAPATTE ne cilesine e Administratorit te shoqerise "ALBAVIA" Shpk..

Pas ketij ndryshimi, Administratoret e shoqerise ALBAVIA Shpk. jane si me poshte:

- Z. Jean Louis MARCHAND
- Z. Daniel ROFFET
- Z. Philippe PEYTAVIN
- Z. Didier CHAPATTE
- Z. Hasan HAFIZI

Z. Hasan Hafizi ne cilesine e Administratorit te Autorizuar te shoqerise ALBAVIA Shpk. ka kompetencat e percaktuara me Autorizimin e dates 31.12.1999, ndryshuar me Vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "ALBAVIA" Shpk. te dates 29.06.2000.

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", i drejtohemi Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane me kerkesen per regjistrimin e ndryshimit ne kollonen perkatese te regjistrit tregtar dhe depozitimin ne aneksin e tij te Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise, date 12.06.2001.

Nderime

Administrator

Hasan Hafizi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 3470 **Rep.**
Nr. — **Kol.**

VERTETIM

Ne Tirane, sot me 4 . 04 .2003, perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Z. Hasan Hafizi, shtetas shqiptar, lindur me 11.02.1952 ne Lezhe, person madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje Noterit.

Pasi une Noteri, ia lexova dhe ia shpjegova aktin bashkengjitur ketij vertetimi, ai me deklaroi se e kupton, e pranon dhe se e ka hartuar ate ne perputhje te plote me vullnetin e tij te lire, dhe e nenshkruan rregullisht ne pranine time, gje te cilen une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTER

Hasan Robo

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM HASAN ROBO NOTER TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM HASAN ROBO NOTER TIRANE

100 LEKE

RESHQIPERISE

ALPHA BANK A.E.
TIRANA BRANCH

MANDAT ARKETIMI

DEPOSIT

ALL

DATA/Date: 22/09/2000

Nr i llogarise/Account No: 020.46.51.00.00.4151

EMRI, TITULLI I PLOTE / Full Name, Company Name: HAFIZI HASAN I RAMIZIT

Llojl i Transaksionit Transaction Type	UTN	Pershkrimi Reference	Disponibiliteti/Data Valute Availability/Value Date	SHUMA AMOUNT
310-Nga Depozita me Afat	85307	INTERESI E DEPOZITES ME AFAT	22/09/2000, 22/09/2000	19,722.00
020-Tek Depozita me Afat	85307	TATIMI I INTERESIT SE DEPO. ME AFAT	22/09/2000, 22/09/2000	-1,972.00
020-Tek Depozita me Afat	85307	INTER. DEBITOR PER PRISHJEN E DEPO. AFAT	22/09/2000, 22/09/2000	-17,750.00
310-Nga Depozita me Afat	85307	PRISHJE PARA AFATIT E DEP. AFAT	22/09/2000, 22/09/2000	2,056,738.00
			TOTALI / TOTAL	2,056,738.00

CURRENCY:
X =
X =
X =
X =
X =
X =
X =
X =
X =
X =

E DY MILION E PESEDHJETE E GJASHTE MIJE SHTATEQIND E TRIDHJETE E TETE

AUTORIZIMI / AUTHORIZATION

Transaksionet e mesiperme me ALPHA BANK A.E.-TIRANA BRANCH burojne nga veprimtari te ligjshme dhe nuk kane per qellim fshehjen ose maskimin e origjines se paligjshme te pasurise

Deklarimi behet per efekt te vertetesise se plotesimit te Formularit te Veprimeve ne Cash.

KLIENTI / CUSTOMER

[UID25, BURD22-25] 22/09/2000 10:39:32

1/2

PULLE TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE NOTER AGIM XH. ROBO TIRANE

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 5250 Rep Dt 26/12/00
VERTETIM
Vërtetohet se fotokopia është e njëllojtë me originalin. Dokumenti U Paraqit H. Hasan
Nr Pasaip e Tokës
NOTER AGIM ROBO

REPUBLIKA E SHQIPERISE NOTER AGIM XH. ROBO TIRANE

No. **00001572**

ALPHA CREDIT BANK
TIRANA BRANCH

ÇEK BANKAR

Data
Date 22/9/2000

No. 000261

Paguani
Pay ALBAVIA SHPK, 300/259/101, TIRANA BANK

Shumen prej
The sum of LEK E DY MILION E PESEDHJETE MIJE VETEM

Shuma
Amount LEK ######2,050,000.00

Ne
To ALPHA BANK, TIRANA BRANCH
HASAN RAFIZI,LLOG.5100004151

ALPHA CREDIT BANK A.E.
TIRANA BRANCH

ORFEA DHUCI

ALMIDA ASLLANI

ALPHA CREDIT BANK TIRANA BRANCH 22-09-00

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM XH. ROBO NOTER TIRANE

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 8251 Rep Dt 26/12/00
VERTETIM
Vertetohet se fotokopia është e njëjtë me originalin Dokumenti U Paraqit
Nr Pasap
NOTER AGIM ROBO

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM XH. ROBO NOTER TIRANE

H71DMR E3N Transaction History Enquiry 14:35 02 OCT 2000 Page 1

0100-300259-101 ALBAVIA Business Sight A/C Albanian Lek

Particulars	Debits	Credits	Posted	Account balance
		Credit balance	01SEP	9,767.72CR
DEP-Cash Deposit DERDHJE PER SHTESE KAPITALI NGA HASAN HAFIZI Value date 22SEP00		1,450,000.00	21SEP - 14 -	1,459,767.72CR
CHQ-Cheque Payment CH/0113772/1 SILVANA LAMAJ PAS/1078775	1,450,000.00-		22SEP - 15 -	9,767.72CR
TRF-Transfer CR 001/0/791 CHEQ FROM ALPHA CREDIT HASAN HAFIZI SHTESE KAPITALI Value date 25SEP00		2,050,000.00	22SEP - 16 -	2,059,767.72CR
CHQ-Cheque Payment CH 0113774 HAMITI KASTRIOT	1,000,000.00-		26SEP - 17 -	1,059,767.72CR
		Credit balance	29SEP	1,059,767.72CR

END OF REPORT

NOTER TIRANE

Entre les soussignés

EUROVIA SA, Société Anonyme au capital de 183.200.000 Euros, dont le siège social est à RUEIL MALMAISON (92250) - 18, place de l'Europe, immatriculée au Registre du Commerce et des Sociétés de Nanterre sous le N° 348 866 260,
Représentée par Roger MARTIN, Président-Directeur Général
ci-après dénommée le Prêteur,

et

ALBAVIA, Société à Responsabilité Limitée de Droit Albanais, au capital de 23.780.000 lekes dont le siège social est Rruge « Sami FRASHERI » - Pall. 20/1, Shkalla e Pare, Ap. 17 – TIRANA,
Représentée par **Hasan HAFIZI** et **Jean-Louis MARCHAND**, Administrateurs

ci-après dénommée l'Emprunteur,

APRES AVOIR PREALABLEMENT EXPOSE CE QUI SUIT

ALBAVIA est sollicitée pour être attributaire d'un marché de réfection de voirie entre Tirana et Durrës et dans Tirana même. Ce marché consiste principalement dans la fourniture et la mise en œuvre d'enrobés et se monte à environ 110.000.000 Lekes soit environ 815.000 Euros.

Malgré l'avance au démarrage, ALBAVIA se trouve avoir un besoin de trésorerie de l'ordre de 550.000 Euros afin de pouvoir commander et régler les fournitures nécessaires à ce chantier.

EUROVIA est d'accord pour prêter cette somme à sa filiale dans les conditions décrites ci-après.

IL A ETE CONVENU CE QUI SUIT

Article 1 – Objet

Le Prêteur consent à l'Emprunteur un prêt aux fins exclusives de lui permettre de régler le coût des fournitures visés ci-dessus.

Article 2 – Montant

Le montant du prêt est de 550.000 (CINQ CENT CINQUANTE MILLE) Euros.

Article 3 – Mise à disposition - Tirage

Cette somme sera mise à la disposition de l'Emprunteur dès la signature du marché de travaux.

L'Emprunteur utilisera ce prêt en un seul tirage qui ne pourra avoir lieu que contre la remise au Prêteur d'une copie certifiée conforme du marché visé dans le préambule.

Article 4 – Intérêts

Le présent prêt portera intérêts au taux de 6,50 % par an. Toutefois cet intérêt ne courrera qu'à compter de la date du tirage.

PULLE TAKSE

Article 5 – Durée - Remboursement

La durée du présent prêt sera au maximum égale à trois mois à compter de ce jour.

100 LEKE

L'Emprunteur procédera au remboursement de la somme empruntée en une seule fois à l'échéance.

Ce remboursement s'effectuera par virement au bénéficiaire sur le compte SOCIETE GENERALE COURBEVOIE :

- Code Banque : 30003
- Code guichet : 04250
- Compte n° 00020166792 Clé Rib 04

Tout retard de paiement ouvrira automatiquement droit à un intérêt de retard égal à deux fois le taux d'intérêt légal.

Article 6 – Loi applicable – Tribunaux compétents

Seule la version française du présent prêt est contractuelle.

Le présent contrat est régit par la loi française et les tribunaux frnaçais seront seuls compétents pour connaître de tout litige concernant son interprétation ou son exécution.

Fait à Rueil,
le 3 Mai 2000.

EUROVIA **ALBAVIA**

REPUBLIKA SHQIPERISE DHOMA E NOTERVE TIRANE Nr 8246 Rep Dt 26/12/00 VERTETIM Vërtetohet se fotokopja është e njëjtë me originalin Dokumenti U Paraqit Nr Pasap NOTER AGIM ROBO

KONTRATE HUAJE

Midis të nënshkruarve,

EUROVIA SA, Shoqëri Anonime me kapital prej 183.200.000 Euro, selia qëndrore e së cilës ndodhet në RUEIL-MALMAISON (92250) – 18, place de l'Europe, e regjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe të Shoqërive të Nanterre me numrin 348 866 260,
E përfaqësuar nga **Roger MARTIN**, President - Drejtor i Përgjithshëm

më poshtë e quajtur Huadhënësi,

dhe

ALBAVIA, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas Të Drejtës Shqiptare, me kapital prej 23.780.000 Leke, selia qendrore e së cilës ndodhet në Rruga "Sami Frashëri", Pall. 20/1, Shkalla e parë, Ap. 17 – TIRANË,
E përfaqësuar nga **Hasan HAFIZI** dhe **Jean-Louis MARCHAND**, Administratorë,

më poshtë e quajtur Huamarrësi.

PAS EKSPOZIMIT PARAPRAKISHT TE SA MË POSHTË

ALBAVIA është kërkuar për të zbatuar një kontratë riparimi rruge midis Tiranës dhe Durrësit dhe brenda qytetit të Tiranës. Kjo kontratë konsiston kryesisht në furnizim vendosjen e shtresave asfaltike dhe arrin në rreth 110.000.000 Leke ose 815.000 Euro.

Megjithë paradhënien e fillimit të punimeve, ALBAVIA ndodhet përballë nevojës në buxhet për rreth 550.000 Euro me qëllim që të mundë të porosisë dhe paguajë furniturat e nevojshme për këtë objekt.

EUROVIA është dakort për t'i dhënë hua këtë shumë filialit të saj nën kushtet e mëposhtme.

ËSHTË RËNË DAKORT SI MË POSHTË

Artikulli 1 – Objekti

Huadhënësi i jep Huamarrësit një hua për qëllime ekskluzive, për t'i mundësuar atij pagesën e kostos së furniturave të mësipërme.

Artikulli 2 - Shuma

Shuma e huasë është 550.000 (PESË QIND E PESËDHJETË MIJË) Euro.

Artikulli 3 - Vënia në dispozicion – Tërheqja

Kjo shumë do të vihet në dispozicion të Huamarrësit sapo të nënshkruhet kontrata e punimeve.

Huadhënësi do ta përdorë këtë hua me një tërheqje të vetme e cila do të bëhet pasi t'i dorëzohet Huamarrësit një kopje te certifikuar konform të kontratës së përmendur më lart.
Pas tërheqjes, shuma përkatëse do të xhirohet në llogarinë e Huamarrësit n°. 001318 pranë TIRANA BANK, Blvd "Dëshmorët e Kombit" 55/1, Tiranë (Shqipëri).

Artikulli 4 – Interesat

Kjo hua do të përmbajë interesa me përqindje 6,50 % në vit. Këto interesa hyjnë në fuqi duke filluar nga data e tërheqjes.

Artikulli 5 – Kohezgjatja – Rimbursimi

Kohëzgjatja e kësaj huaje do të jetë maksimumi e barabartë me tre muaj duke filluar nga kjo ditë.

Huadhënësi do të procedojë me rimbursimin e shumës së huazuar vetëm me një skadencë të vetme.

Ky rimbursim do të kryhet me xhirim kundrejt përfituesit në llogarinë SOCIETE GENERALE COURBEVOIE:

- Kodi i Bankës : 30003
- Kodi i Sportelit : 04250
- Llogaria n°. 00020166792 Çelësi Rib 04

Çdo vonesë pagese do të çojë automatikisht në të drejtën e nje interesi vonese dy herë me të lartë se interesi i zakonshëm.

Artikulli 6 – Ligji i aplikueshëm – Gjyqet kompetente

Vetëm versioni ne frëngjisht i kësaj huaje është kontraktual.

Kjo kontratë është e përcaktuar nga ligji francez dhe gjyqet franceze do të jenë të vetmet organe kompetente për t'u marrë me çdo grindje lidhur me interpretimin apo zbatimit e saj.

Bërë në Rueil,
më 3 Maj 2000.

EUROVIA **ALBAVIA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. ...8245....Rep.

VERTETIM

Une i neneshkruari, Agim Xh. Robo, noter ne qytetin e Tiranes, Rruga Ismail Qemali, P. 27/1, vertetoj se kam perkthyer sa me siper nga frengjishtja ne shqip njelloj me dokumentin bashkelidhur.

Tirane, me ...26.12....2000

NOTERI

Agim XH. ROBO

PULLE TAKSE

100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTER TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGIM XH. ROBO NOTER TIRANE

---------- Instance Type and Transmission ----------
Original received from SWIFT
Priority : Normal
Message Output Reference : 1022 000512TIRBALTRAXXX2640044001
Correspondent Input Reference : 1006 000512SOGEFRPPEXXX1258900655
---------- Message Header ----------
Swift Output : FIN 100 customer transfer
Sender : SOGEFRPPXXX
SOCIETE GENERALE
PARIS FR
Receiver : TIRBALTRXXX
TIRANA BANK
TIRANA AL
MUR : 13312617
---------- Message Text ----------
20: transaction reference no.
0417013306350000
32A: value date,currency and amount
Date : 12 May 2000
Currency : EUR (EURO)
Amount : #550,000,#
50: ordering customer
EUROVIA SA
18 PLACE DE L EUROPE
92565 RUEIL MALMAISON CEDEX
57D: account with institution - address
TIRANA BANK SA
ALBAVIA
BLVD DESHMORET E KOMBIT 55 1
59: beneficiary customer
/001318
ALBAVIA SH PK
ALBANIE
70: details of payment
PRET
71A: details of charges
BEN
---------- Message Trailer ----------
{MAC:6BF3AAB4}
{CHK:BEFF878D87CC}

BANKA e TIRANES SH.A
1 2 MAY 2000
U MORR NE DOREZIM

Pos P

TIRANA BANK
M0100762

TRN IN ACC
DT 12.05.00

PULLE TAKSE

REPUBLIKA SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr 8248 Rep Dt 26/12/00
VERTETIM
Vërtetohet se fotokopja është e
njëjtë me origjinalin. Dokumenti
U Paraqit
Nr Pasap
NOTER AGIM ROBO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGIM XH. ROBO
NOTER
TIRANË

(3)

19077/2
15. 01. 2001

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCI KOMBETARE E NOTERIT TIRANE

KERKESE

Kerkuesi: Shoqeria ALBAVIA SHpk., regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr.19077, date 19.03.1998, perfaqesuar nga Administratori Z. Hasan Hafizi.

Objekti: Depozitimi i Vendimit te Asamblese se Ortakeve te dates 29.06.2000 per miratimin e doreheqjes se Administratorit Z. Maurice Moisy dhe zevendesimin e tij me Z. Luc Bodson, vendimit per rishikimin e kompetencave te Z. Hasan Hafizi ne cilesine e Administratorit te autorizuar te shoqerise dhe depozitimi i Vendimit te Asamblese se Ortakeve te dates 29.06.2000 per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga 23.780.000 Leke ne 48.134.000 Leke si dhe pasqyrimi i ndryshimeve perkatese ne statutin e shoqerise.

Baza Ligjore: Ligji nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Shoqeria ALBAVIA Shpk. eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr.19077, date 19.03.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Ne daten 29.06.2000, Asambleja e Ortakeve te shoqerise Albavia Shpk., unanimisht ka vendosur si me poshte:

1. Miratimin e doreheqjes se Administratorit Z. Maurice Moisy dhe zevendesimin e tij me Z. Luc Bodson.

Z. Bodson do te kete te njejtat kompetenca qe kishte Z. Moisy ne detyren e Administratorit.

Me kete ndryshim, Administratoret e shoqerise ALBAVIA Shpk. jane si me poshte:

- Z. Jean Louis Marchand
- Z. Hasan Hafizi
- Z. Philippe Peytavin
- Z. Luc Bodson

2. Rishikimin e kompetencave te Z. Hasan HAFIZI, ne cilesine e Administratorit te Autorizuar shoqerise sipas autorizimit te dates 31 dhjetor 1999 (autorizim i cili i bashkengjitet vendimit te asamblese). Kompetencat e Z. Hafizi ndryshojne si me poshte:

- Ne paragrafin 1.12 te autorizimit te siperpermendur, shuma 10.000.000 (dhjete milione) Leke ndryshohet ne 20.000.000 (njezet milione) Leke.
- Permbajtja e paragrafit 1.17 te autorizimit ndryshohet si vijon: "Te kryeje blerjet e mallrave te ngurtesuara ne llogari me vlere me te madhe se 20.000 (njezet mije) USD.
- Ne paragrafin 4.1 te autorizimit, shuma 100.000.000 (njeqind milione) Leke ndryshohet ne 200.000.000 (dyqind milione) Leke.
- Ne paragrafin 4.2 te autorizimit, shuma 100.000.000 (njeqind milione) Leke ndryshohet ne 200.000.000 (dyqind milione) Leke.

3. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga 23.780.000 (njezet e tre milione e shtateqind e tetedhjete mije) Leke ne 48.134.000 (dyzet e tete milione e njeqind e tridhjete e kater mije) Leke si dhe pasqyrimi i ndryshimeve perkatese ne statutin e shoqerise.

Per te realizuar zmadhimin e kapitalit te shoqerise si me siper, ortaku Hasan Hafizi do te derdhe ne llogarine bankare te shoqerise ALBAVIA Shpk., shumen prej 7.380.000 (shtate milione e treqind e tetedhjete mije) Leke.

Ortaku EUROVIA INTERNATIONAL i ka dhene shoqerise ALBAVIA Shpk. nje hua ne shumen 550.000 (peseqind e pesedhjete mije) Euro ne baze te kontrates se huase te lidhur midis tyre ne date 3 maj 2000. EUROVIA INTERNATIONAL do te zbrese nga kjo hua ekuivalencen e shumes 16.974.000 (gjashtembedhjete milione e nenteqind e shtatedhjete e kater mije) Leke e cila do te perdoret per te shlyer pjesen qe ortaku EUROVIA INTERNATIONAL kontribuon per zmadhimin e kapitalit te shoqerise ALBAVIA Shpk..

Me realizimin e ketij zmadhimi, kapitali i shoqerise behet 48.134.000 (dyzet e tete milione e njeqind e tridhjete e kater mije) Leke i ndare ne 587 kuota nga Leke 82.000 (tetedhjete e dy mije) Leke secila dhe zoterohet nga ortaket si me poshte ndahet si vijon:

EUROVIA INTERNATIONAL	- 409 kuota ose 69,68 % e kapitalit
Hasan Hafizi	- 178 kuota ose 30,32 % e kapitalit

Me qellim qe ndryshimet e mesiperme te pasqyrohen ne statutin e shoqerise ortaket vendosen te bejne ndryshimet e meposhtme ne statut:

"Neni 14

Kapitali i shoqerise eshte 48.134.000 (dyzet e tete milione e njeqind e tridhjete e kater mije) Leke i ndare ne 587 kuota nga 82.000 (tetedhjete e dy mije) Leke secila.

Neni 15

Kapitali i shoqerise eshte i ndare midis ortakeve si me poshte:

EUROVIA INTERNATIONAL	- 409 kuota ose 69,68 % e kapitalit
Hasan Hafizi	- 178 kuota ose 30,32 % e kapitalit"

Asambleja e Ortakeve unanimisht autorizon Z. Hasan Hafizi qe te perfaqesoje shoqerine ALBAVIA Shpk. duke nenshkruar çdo dokument e duke kryer te gjitha veprimet e nevojshme per te depozituar dhe regjistruar kete vendim te Asamblese se Ortakeve te shoqerise ne regjistrin tregtar shqiptar. Z. Hasan Hafizi i njihet e drejta qe te emeroje avokate dhe t'i autorizoje qe te pergatisin dhe te nenshkruajne ne emer te tij dokumentacionin perkates dhe te kryejne te gjitha veprimet e nevojshme per te realizuar qellimin e siperpermendur.

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", i kerkojme Gjykates suaj pranimin e kesaj kerkese dhe depozitimin ne Regjistrin Tregtar te vendimit te Asamblese se Ortakeve te dates 29.06.2000 per miratimin e doreheqjes se Administratorit Z. Maurice Moisy dhe zevendesimin e tij me Z. Luc BODSON, vendimit per rishikimin e kompetencave te Z. Hasan HAFIZI ne cilesine e Administratorit te autorizuar te shoqerise dhe depozitimi i Vendimit te Asamblese se Ortakeve per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga 23.780.000 Leke ne 48.134.000 Leke si dhe pasqyrimi i ndryshimeve

perkatese ne statutin e shoqerise.

Nderime

Hasan HAFIZI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 8125 **Rep.**
Nr. — **Kol.**

VERTETIM

